

## KONGRESI I DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

(20-25 nëntor 1972)

«Para disa ditësh zhvilloi punimet historike Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës sonë të bukur.

Kjo është një fitore e pallogaritshme në mes të aq fitoreve të tjera madhështore që ka korrur populli ynë me luftë, me përpjekje e me zotësi».

**Enver Hoxha**

Nga 20 deri më 25 nëntor 1972 zhvilloi punimet në Tiranë *Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe*, që u organizua me inisiativën e Institutit të gjuhësisë e të letërsisë të Universitetit Shtetëror të Tiranës. Ky Kongres u mbledh si forumi më i lartë shkencor në shkallë kombëtare për të diskutuar e për të marrë vendime të rëndësishme për drejtshkrimin e gjuhës së sotme shqipe dhe në një vështrim më të gjerë për çështje që lidhen me normën letrare. Në këtë Kongres morën pjesë 87 delegatë nga të gjitha rrethet e vendit, përfaqësues të shqiptarëve që jetojnë në Jugosllavi — në Kosovë, në Maqedoni e në Mal të Zi, si dhe të arbëreshëve të Italisë. Ndërmjet delegatëve ka studjues të gjuhës shqipe nga institutet kërkimore shkencore, pedagogë nga shkollat e larta, mësues të gjuhës e të letërsisë shqipe nga shkollat e niveleve të ndryshme, shkrimtarë, publicistë, punonjës të ndërmarrjeve e të enteve botuese, veteranë të arësimit e të tjerë.

Veç delegatëve punimet e Kongresit i ndoqën edhe mbi treqind pjesëmarrës e të ftuar që punojnë në fusha të ndryshme të veprimtarisë së gjuhës së shkruar shqipe brenda e jashtë atdheut, studjues e lëvruar të gjuhës shqipe, mësues, shkrimtarë e gazetarë, si dhe studjues e albanologë nga RD Gjermane, Franca, Bullgaria.

Punimet e Kongresit të drejtshkrimit të gjuhës shqipe filluan me seancë plenare më 20 nëntor 1972 në ora 9, në sallën e Kuvendit Popullor. Përveç delegatëve, pjesëmarrësve dhe të ftuarve, ndodheshin gjithashtu udhëheqës të Partisë e të Shtetit shokët Enver Hoxha, Abdyl Këllezi, Adil Çarçani, Kadri Hazbiu, Koço Theodhosi, Manush Myftiu, Mehmet Shehu, Ramiz Alia, Rita Marko, Spiro Koleka, Pilo Peristeri, Pirro Dodbiba, Xhafer Spahiu, nënkryetari i Presidiumit të Kuvendit Popullor Shefqet Peçi, kryetari i Kuvendit Popullor Fadil Paçrami, anëtarë të Komitetit Qendror të Partisë, të Presidiumit të Kuvendit Popullor, të Qeverisë dhe shokë të tjerë.

Punimet e seancave plenare të Kongresit u drejtuan nga një presidium, i përbërë prej 21 vetësh: *Thoma Deliana* — ministër i arësimit dhe i kulturës, *Agim Mero* — rektor i Universitetit Shtetëror të

Tiranës, anëtarët e komisionit organizues Prof. *Androkli Kostallari*, Prof. *Mahir Domi*, Prof. *Eqrem Çabej*, Prof. *Idriz Ajeti*, Prof. *Dhimitër Shuteriqi*, Prof. *Aleks Buda*, Dr. *Rexhep Qosja*, Prof. *Shaban Demiraj*, B. vj. shk. *Lirak Dodbiba*, *Kolë Koci*, Mr. *Remzi Nesimi*, B. vj. shk. *Jorgji Gjinari*, Doc. *Anastas Dodi*, *Emil Lafe*, Doc. *Jup Kastrati*, *Engjëll Angoni*, *Ali Abdihoxha*, *Luigj Franja*, Prof. *Josif Ferrari*.

Fjalën e hapjes e mbajti ministri i arësimit e i kulturës *Thoma Deliana*.

*Fjala e hapjes mbajtur nga ministri i arësimit e i kulturës  
shoku Thoma Deliana*

«Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe, i cili po hap sot punimet e tij në Tiranë, është ndër ngjarjet më të shënuara në jetën shkencore e kulturore të vendit. Ky është kongresi i dytë në historinë e gjuhës shqipe, pas atij të Manastirit, që u mbajt në vitin 1908. Që nga ajo kohë gjuha letrare shqipe ka përshkuar një rrugë të gjatë dhe plot pengesa në zhvillimin dhe përsosjen e saj. Një plejadë e tërë lëvruesh të shquar të gjuhës — shkrymtarë, arësmtarë, patriotë etj. — punuan me zell dhe këmbëngulje për njësimin, pasurimin dhe përsosjen e gjuhës letrare shqipe. Por aspirata e mendjeve përparimtare dhe e patriotëve tanë për një gjuhë letrare kombëtare nuk u realizua dhe as që mund të realizohej dot në të kaluarën. Vetëm pas ngadhnjimit të revolucionit popullor e të vendosjes të rendit socialist, kur zhvillimi ekonomik dhe kulturor-arësmtor i vendit tonë mori përmasa të papara për historinë tonë kombëtare, u krijuan kushte dhe mundësi shumë të favorshme për krijimin e gjuhës letrare kombëtare të përbashkët. Kongresi do të kurorëzojë përpjekjet e parreshtura që janë bërë nga përfaqësuesit më të përparuar të mendimit shkencor-arësmtor të vendit tonë në drejtim të njësimin të gjuhës sonë letrare kombëtare.

Ky Kongres mblidhet si forumi më i lartë shkencor kombëtar për të diskutuar e për të marrë vendime të rëndësishme për gjuhën tonë letrare dhe për drejtshkrimin e saj. Në këtë vështrim Kongresi përbën një ngjarje me rëndësi historike për kulturën tonë kombëtare, për zhvillimin e arësimit dhe të shkollës sonë socialiste. Ai pasqyron shndërrimet e mëdha shoqërore, arësmtore e kulturore që kanë ndodhur në vendin tonë, është shprehje e zhvillimit të pandërprerë dhe me ritme të larta të kërkimeve e studimeve albanologjike nga forcat shkencore shqiptare në vitet e pasclirimit. Nuk e tepërojmë po të themi se në fushën e studimit të gjuhës shqipe letrare dhe të drejtshkrimit të saj tani e thonë fjalën plotësisht e me autoritet studjuesit tanë shqiptarë.

Kanë kaluar pesë vjet që nga botimi i projektit të «Rregullave të drejtshkrimit të shqipes». Gjatë kësaj kohe u bënë përpjekje të mëdha që këto të vihen në zbatim nga shkolla jonë, nga shtypi, nga institucionet e ndërmarrjet e botimit. Kjo periudhë qe një kohë e nevojshme për provën praktike të këtyre rregullave. Ajo qe gjithashtu e mbushur me diskutime të shumta nëpër shkolla, në mbledhje, në konsulta dhe në rrethe shkencore. Një kontribut të madh në diskutimin e rregullave të drejtshkrimit dhanë me vërejtjet dhe sugjerimet e tyre mësuesit e gju-

hës shqipe, të cilët u bënë bartësit dhe zbatuesit më të flaktë të normës së njësuar letrare. Diskutimi masiv i rregullave të drejtshkrimit është një dëshmi e gjallë e interesimit që tregohet për problemin e njësimit të gjuhës sonë letrare, si një nga format kryesore të kulturës sonë kombëtare.

Njësia e drejtshkrimit është shprehje e njësisë së gjuhës dhe njësia e gjuhës është shprehje e njësisë së kombit tonë, prandaj rëndësia e këtij Kongresi i kalon kufijtë e një mbledhjeje të ngushtë specialistësh; punimet e tij i ndjekin me interesim të veçantë masat e gjera, arësimtarët, shkrimtarët, publicistët, gjithë punonjësit e kulturës shqiptare brenda dhe jashtë vendit, sepse drejtshkrimi i njësuar, si shfaqja më e drejtpërdrejtë e gjuhës kombëtare të njësuar, i intereson çdo shqiptari që e shkruan shqipen dhe ka vetëdijën kombëtare.

Gjatë këtyre viteve të pasçlirimit të jetës së popullit tonë gjuha shqipe, në përputhje me shndërrimet e thella ekonomike-shoqërore dhe politike që e nxorën vendin nga prapambetja shekullore dhe e vunë përkrah vendeve më të përparuara, ka arritur një nivel të lartë zhvillimi dhe sot është në fazën e kristalizimit të saj të plotë. Si gjuhë letrare kombëtare, ajo po vepron në të gjitha sferat e marrëdhënjeve midis njerëzve dhe po përsoset më tej në përputhje me kërkesat e zhvillimit të shoqërisë sonë socialiste. Ajo po vepron me sukses edhe në shkollën shqipe, në shtypin e në letërsinë e shqiptarëve që jetojnë në Jugosllavi (në Kosovë, në Maqedoni, dhe në Mal të Zi), përfaqësuesit e të cilëve marrin pjesë në këtë Kongres. Normat e kësaj gjuhe kanë ngjallur interes edhe tek arbëreshët e Italisë. Kështu po realizohet një nga ëndërrat më të mëdha të patriotëve tanë, të luftëtarëve të lirisë dhe të lëvruesve të shqipes, të cilët punuan e u përpoqën me aq mund e zell për çështjen kombëtare dhe për një gjuhë të përbashkët.

Kongresi i drejtshkrimit do të shqyrtojë e do të vendosë për çështje që lidhen drejtpërdrejt dhe me vetë punën e shkollës. Njësimi, përpunimi dhe stabilizimi i normës letrare realizohen jo vetëm përmes lëndëve të gjuhës shqipe dhe të letërsisë, por edhe përmes lëndëve të tjera mësimore. Duke njohur meritën e gjertanishme të teksteve dhe të praktikës së shkollës sonë në formimin e shprehive të drejta gjuhësore tek nxënësit, është e nevojshme të theksohet se, në dritën e vendimeve që do të marrë ky Kongres, roli i shkollës sonë në këtë drejtim duhet të rritet më tej në të ardhmen. Dhe nuk ka asnjë dyshim se pikërisht shkollës i takon misioni historik për të qenë në ballë të kësaj lufte.

Përveç shkollës, një kontribut të shënuar në ngulitjen e normës letrare kanë dhënë shtypi ynë, radioja, letërsia artistike dhe botimet e tjera, të cilëve paskëtaj, u bie barra që frontalisht ta çojnë më tej këtë punë, në mënyrë më të gjërë e më të thelluar.

Kongresi i drejtshkrimit të shqipes po i zhvillon punimet e tij në prag të dy festave të shënuara historike për vendin dhe popullin tonë, 60-vjetorit të shpalljes së pavarësisë dhe 28-vjetorit të çlirimit të Atdheut e të fitores së revolucionit popullor. Kjo ka një kuptim të veçantë simbolik për Kongresin tonë, sepse lufta për gjuhën shqipe, për një gjuhë të përbashkët, lufta për ta ruajtur këtë gjuhë nga asimilimi i huaj dhe për ta zhvilluar atë më tej, ka qenë e lidhur pazgjidhshmë-

risht me gjithë lëvizjen, me betejat për pavarësinë dhe për çlirimin kombëtar.

Duke përfunduar, më lejoni të falënderoj udhëheqësit e Partisë e të Shtetit, me shokun Enver Hoxha në krye, për nderin që na bëjnë me pjesëmarrjen e tyre në këtë Kongres. Prania e tyre është shprehje e qartë e kujdesit dhe e përkrahjes që Partia dhe Shteti ynë i japin zhvillimit të shkencës sonë shqiptare.

Punimet e Kongresit i ndjekin edhe albanologë të huaj, që interesohen drejtpërdrejt për gjuhën shqipe; përfitoj nga rasti t'i përshëndes dhe t'u uroj mirëseardhjen në vendin tonë. Më lejoni të përshëndes në mënyrë të veçantë shkencëtarët nga radhët e shqiptarëve që jetojnë në Jugosllavi, — nga Kosova, Maqedonia e Mali i Zi, si dhe nga arbëreshët e Italisë, me të cilët na lidhin përpjekjet e përbashkëta për zhvillimin dhe pasurimin e gjuhës sonë letrare kombëtare. Gjithashtu, më lejoni të përshëndes nxehetësisht delegatët, të cilët, me dijet dhe aftësitë e tyre, kanë marrë përsipër të realizojnë misionin e madh historik të këtij Kongresi. Falënderoj njëkohësisht të gjithë pjesëmarrësit e tjerë dhe në mënyrë të veçantë ata që ndihmuan në përgatitjen e këtij Kongresi e që kanë vënë përpjekjet dhe aftësitë e tyre për zhvillimin dhe përparimin e gjuhës sonë letrare kombëtare.

Duke e shpallur të hapur Kongresin e drejtshkrimit të gjuhës shqipe, ju uroj punë të mbarë dhe suksese».

Pas fjalës së hapjes, Ministri i arësimit e i kulturës Thoma Deliana ia dha fjalën drejtorit të Institutit të gjuhësisë e të letërsisë të Universitetit Shtetëror të Tiranës prof. *Androkli Kostallarit*, i cili gjatë dy seancave plenare të paradites lexoi referatin «*Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj*».

Teksti i plotë i referatit botohet në këtë numër të buletinit «*Studime filologjike*».

Po këtë ditë, në seancën plenare të pasdites, që u drejtua nga rektori i Universitetit Shtetëror të Tiranës Agim Mero, u mbajtën kumtesat: «Parimi fonetik e zbatimi i tij në drejtshkrimin e shqipes» nga prof. *Mahir Domi*, «Mbi disa çështje të traditës së shkrimit dhe të drejtshkrimit të shqipes» nga prof. *Eqrem Çabej*, «Rruga e zhvillimit të gjuhës letrare shqipe në Kosovë» nga prof. *Idriz Ajeti* (Prishtinë), «Rreth akselerimit psiqik dhe ndikimit të tij në mësimin e gjuhës letrare» nga prof. *Bedri Dedja*, «Shkrimtarët dhe drejtshkrimi» nga prof. *Dhimitër Shuteriqi*, «Procesi i njësimin të drejtshkrimit të shqipes letrare në Maqedoni» nga prof. *Remzi Nesimi* (Shkup) dhe «Mbi marrëdhënjet e drejtshkrimit me drejtshqiptimin» nga doc. *Anastas Dodi*.

Më 21 nëntor para dite Kongresi i vazhdoi punimet në dy seksione. Në seksionin e parë, ku u trajtuan «çështje të drejtshkrimit të zanoreve e të bashkëtingëlloreve» u mbajtën kumtesat: «Drejtshkrimi, gjuha letrare dhe dialektet» nga bashkëpunëtori i vjetër shkencor *Jorgji Gjinari*, «Rreth parimit tradicional, historik në drejtshkrimin e shqipes» nga *Bahri Beci*, «Vijat e përgjithshme të zhvillimit historik të drejtshkrimit të shqipes» nga doc. *Jup Kastrati*, «Rregullat e drejtshkrimit të shqipes dhe përjashtimet» nga bashkëpunëtori i vjetër shkencor *Lirak Dodbiba*, «Mbi zbatimin e gjuhës letrare shqipe dhe

«Disa vërejtje rreth projektit të drejtshkrimit» nga *Ismail Doda* (Ostros), «Disa aspekte pedagogjike-psikologjike të përvetësimit të drejtshkrimit» nga *Shefik Osmani*, «Disa vërejtje periferike rreth drejtshkrimit të shqipes» nga prof. *Ajet Bytyçi* (Prizren), «Mbi disa plotësime të mëtejshme në rregullat e drejtshkrimit» nga *Jorgji Çerepi*, «Problemet e drejtshkrimit në botimet e folklorit» nga bashkëpunëtori i vjetër shkencor *Qemal Haxhihasani*, «Kontribut për tri pika të drejtshkrimit» nga asistent *Isa Bajçinca* (Prishtinë), «Mbi rrugën e kapërcimit të vështirësive dialektore në përvetësimin e drejtshkrimit» nga *Ylli Resuli* dhe «Kontributi i drejtshkrimit në rrafshimin e dallimeve dialektore» nga *Pjetër Fusha*.

Në seksionin e dytë, ku u trajtuan «Çështjet gramatikore, të shkrimit të fjalëve bashkë ose ndaras, të përdorimit të shkronjave të mëdha etj; u mbajtën kumtesat: «Çështjet gramatikore në rregullat e drejtshkrimit të shqipes» nga prof. *Shaban Demiraj*, «Parimi morfologjik në drejtshkrimin e shqipes» nga *Fatmir Agalliu*, «Për një thjeshtim të mëtejshëm të rregullave të drejtshkrimit të shqipes» nga *Hasan Sazani*, «Dublete e inkosekuenca në rregullat e drejtshkrimit të shqipes» nga *Ali Dhrimo*, «Mbi rolin e shtypit në ngulitjen dhe përhapjen e normës drejtshkrimore» nga *Nikoleta Cikuli*, «Procesi i njësimin të dubleteve drejtshkrimore në ortografinë e viteve 1948, 1951, 1956 dhe 1967» nga *Tomor Osmani*, «Rëndësia e drejtshkrimit për formimin gjuhësor të mësuesit» nga *Luigj Franja*, «Projekti i rregullave të drejtshkrimit dhe probleme e vështirësi që i dalin shtëpisë botuese të librit shkollor e punës së gjallë të mësuesve e nxënësve në klasë» nga *Mërkur Alimerko*, «Mbi plotësimin e mëtejshëm të rregullave të drejtshkrimit të shqipes» nga *Triumfe Hoti*, «Për kufizimin e përjashtimeve në rregullat e drejtshkrimit të shqipes» nga *Qani Përtafi* dhe «Drejtshkrimi — element i rëndësishëm i përvetësimit të normës letrare në shkollën tetëvjeçare» nga *Faik Luli*.

Pas kumtesave, nga të pranishmit e të dy seksioneve, u bënë diskutime.

Pas dite, në të dy seksionet e Kongresit të drejtshkrimit të gjuhës shqipe, vazhdoi mbajtja e kumtesave.

Në seancën e dytë të seksionit të parë u mbajtën këto kumtesa: «Shkrimi i ë-së paratheksore» nga *Menella Totoni*, «Rreth shkrimit të zanores ë pastheksore jofundore» nga *Sofika Adhami*, «Shkrimi i zanores ë fundore» nga *Elsa Vakëflliu*, «Çështje të shkrimit të zanores ë te mbiemrat e formuar me prapashtesën shëm» nga *Niko Tanini*, «Alternimi ë: zero në drejtshkrimin e shqipes» nga *Luan Dino*, «Drejtshkrimi i zanores ë fundore të patheksuar te emrat e gjinisë femërore» nga *Seit Lila* dhe *Ylli Bajraktari*, «Shkrimi i zanores e të theksuar» nga *Gjovalin Shkurtaj* dhe Mbi disa raste të shkrimit të zanores e të theksuar» nga *Thanas Feka*.

Në seancën e dytë të seksionit të dytë u mbajtën këto kumtesa: «Drejtshkrimi dhe liritë poetike» nga *Ferdinand Leka*, «Drejtshkrimi, drejtshqiptimi dhe roli i teatrit» nga *Mihal Luarasi*, «Mbi trajtimin e shumësit të emrave dhe të mbiemrave në rregullat e drejtshkrimit të shqipes» nga *Lumnie Shehetila*, «Rreth shkrimit të nyjes së përparme» nga *Kristaq Shtëmbari*, «Çështje të drejtshkrimit të përemrave pronorë» nga *Mikel Zavalani*, «Drejtshkrimi i trajtës së shquar të emrave që mba-

rojnë me *o* të patheksuar» nga *Petrit Belli* dhe «Mbi shkrimin e prapshitesës *-ët/t* dhe *-ëm/m*» nga *Dhimitra Lalaj*.

Pastaj në të dy seksionet u bënë diskutime rreth kumtesave të mbajtura.

Të pranishmit në Kongresin e drejtshkrimit të gjuhës shqipe vizituan këtë ditë edhe ekspozitën «*Formimi i gjuhës së sotme letrare shqipe*», organizuar nga Biblioteka Kombëtare.

Edhe më 22 nëntor Kongresi i vazhdoi punimet në dy seksione. Para dite, në seancën e tretë të seksionit të parë, u mbajtën këto kumtesa: «Një komb — një gjuhë letrare» nga prof. *Ali Hadri* (Prishtinë), «Vërejtje gjuhësore të shikuara nga një arbëresh» nga studjuesi arbëresh prof. *Josif Ferrari* (Bari), «Mbi disa çështje të gjuhës letrare kombëtare shqipe dhe të normës letrare» nga doc. *Munir Reso*, «Drejtshkrimi dhe grafika e shqipes» nga *Emil Lafe*, «Shkrimi i bashkëtingëlloreve *r e rr*» nga *Ylli Ruli*, «Shkrimi i bashkëtingëllores *j*» nga *Myfit Trepça*, «Drejtshkrimi i fjalëve me *s* nistore» nga *Naim Bardhi*, «Disa mendime për fonemën *h* dhe shkrimin e saj në gjuhën letrare» nga *Nesti Havjari*, «Takimet e bashkëtingëlloreve *d, t, s, e z*, me *h*-në si problem i drejtshkrimit të shqipes» nga *Krenar Progonati*, «Mbi drejtshkrimin e bashkëtingëlloreve *l e ll*» nga *Niqi Note* dhe «Takimet e bashkëtingëlloreve *g* ose *n* me *j*-në si problem i drejtshkrimit» nga *Abedin Shameti*.

Në seancën e tretë të seksionit të dytë u mbajtën këto kumtesa: «Mbi disa detyra të letërsisë artistike për kristalizimin e normës letrare dhe përsosjen e mëtejshme të gjuhës sonë letrare» nga bashkëpunëtori i vjetër shkencor *Koço Bihiku*, «Shkrimtarët dhe gjuha letrare» nga dr. *Rexhep Qosja* (Prishtinë), «Problemi i kufijve të fjalës në gjuhën shqipe dhe çështje të drejtshkrimit» nga *Jani Thomaj*, «Mbi shkrimin bashkë dhe ndaras të mjeteve të lidhjes së fjalive në periudhë» nga bashkëpunëtori i vjetër shkencor *Spiro Floqi*, «Mbi parimet e shkrimit të fjalëve të prejardhura dhe të përbëra» nga dr. *Latif Mulaku* (Prishtinë), «Disa çështje lidhur me shkrimin e fjalëve bashkë dhe me vizë në mes» nga *Dhimitër Samara*, «Çështje të drejtshkrimit të pjesëzave dhe të pashirmave» nga *Ëngjëll Angoni*, «Çështje të shkrimit të lokucioneve ndajfoljore e parafoljore» nga *Bajram Hajrullaj*, «Mbi përsëritjen e nyjeve, parafjalëve e pjesëzave para gjymtyrëve të bashkërenditura» nga *Sefedin Trungu*, «Mbi drejtshkrimin e numërorëve themelorë» nga *Fuat Ostrozubi* (Prizren), «Mbi shkrimin e nyjes së prapme *-ët, -të* të shumësit të emrave» nga *Vasil Prifti*, «Çështje të shkrimit të numërorëve» nga *Çelik Petriti* dhe «Mbi shkrimin e disa trajtave foljore në të kryerën e thjeshtë» nga *Vasil Theodhori*.

Të pranishmit në të dy seancat bënë diskutime rreth kumtesave të mbajtura.

Pas dite në të dy seksionet e Kongresit të drejtshkrimit të gjuhës shqipe vazhdoi mbajtja e kumtesave. Në seksionin e parë u mbajtën këto kumtesa: «Disa mendime anësore rreth ortografisë së gjuhës shqipe» nga dr. *Petro Janura* (Shkup), «Rreth shkrimit të *sh-/ç-* nistore» nga *Hysen Qosja*, «Shurdhimi i bashkëtingëlloreve dhe norma drejtshkrimore» nga *Vangjel Diamanti*, «Shënime për tingullin *j* në sistemin e drejtshkrimit të gjuhës shqipe» nga *Dragush Çabej*, «Rreth shkrimit me *i* ose *j* të trajtave të shkurtëra të bashkuara» nga *Zhaneta Guxho*,

«Rreth shkrimit të grupeve *ie, je*» nga *Liljana Naçe*, «Mbi drejtshkrimin e zanoreve *u, y, i*» nga *Halil Lalaj* dhe «Mbi drejtshkrimin e zanores *u* të patheksuar te emrat dhe mbiemrat me *-ull, -ur*» nga *Murat Gecaj*.

Në seancën e katërt të seksionit të dytë u mbajtën këto kumtesa: «Mbi shkrimin me *s* ose *t* të foljeve të tipit *shëtis*» nga *Xhabir Topalli*, «Përdorimi i shkronjave të mëdha në emërtimet e institucioneve e të organizatave shoqërore» nga *Remzi Pernaska*, «Rreth shkrimit të datave» nga *Ahmet Limani* dhe «Mbi disa probleme të zbatimit të normës së drejtshkrimit në literaturën tonë mjekësore» nga *Rahim Gjika*.

Pasi u mbajtën kumtesat, të pranishmit në të dy seksionet diskutuan rreth tyre.

Më 23 nëntor punimet e Kongresit vazhduan përsëri në dy seksione.

Në seancën e pestë të seksionit, ku trajtohen probleme të drejtshkrimit të zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve, u mbajtën këto kumtesa: «Mbi shkrimin e fjalëve të huazuara nga latinishtja» nga bashkëpunëtori i vjetër shkencor *Pashko Geci*, «Mbi disa çështje kryesore të drejtshkrimit të fjalëve të huazuara nga gjuhët romane» nga *Fadil Podgorica*, «Mbi shkrimin e fjalëve të huaja që kanë një *kc* të ndjekur nga *io*» nga *Kolë Ashta*, «Mbi shkrimin e fjalëve të huazuara nga greqishtja» nga doc. *Stefan Prifti*. «Rreth drejtshkrimit të emrave të përveçëm të njerëzve» nga *Palok Daka*, «Çështje të drejtshkrimit të emrave të përveçëm nga gjuhët sllave» nga *Xhevat Lloshi*, «Mbi drejtshkrimin e fjalëve të huazuara nga anglishtja» nga *Thanas Shkurti*, «Mbi drejtshkrimin e fjalëve të huazuara nga gjermanishtja» nga *Josif Kole*, «Apostrofi në drejtshkrimin e shqipes» nga *Shefqet Hoxha*, «Mbi disa çështje të diskutueshme të ndarjes së fjalëve në fund të rreshtit» nga *Zhaneta Nova* dhe «Mbi disa çështje të ndarjes së fjalëve në fund të rreshtit» nga *Lajde Staku*.

Në seancën e pestë të seksionit të dytë, ku trajtohen çështje gramatikore, të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, të përdorimit të shkronjave të mëdha etj., u mbajtën këto kumtesa: «Mbi përdorimin e shkronjave të mëdha në titujt e librave, gazetave, revistave dhe në emërtimet e veprave të artit e në monumentet historike» nga *Dhori Qiriazhi*, «Përdorimi i shkronjave të mëdha te emrat gjeografikë të përbërë» nga *Sofika Morcka*, «Mbi drejtshkrimin e njëzuar të emrave gjeografikë të vendit tonë» nga *Nesti Bellovoda*, «Mbi drejtshkrimin e emërtimeve të periudhave, ngjarjeve dhe të dokumenteve historike» nga *Gaqo Peci*, «Mbi drejtshkrimin e shkurtimeve» nga *Drita Garuci*, «Mbi përdorimin e shkronjave të mëdha për qëllime stilistike» nga *Islam Dizdari*, «Nevoja dhe rëndësia e pasurimit të leksikut letrar nga burimet dialektore» nga prof. *Mark Krasniqi* (Prishtinë), «Elementët e huaj në sintaksën e gjuhës shqipe» nga *Kajtaž Reçaj* (Prishtinë) dhe «Mbi përdorimin e shkronjave të mëdha te përemrat vetorë e pronorë» nga *Xhemal Meçaj*.

Pastaj të pranishmit e të dy seksioneve bënë diskutime rreth kumtesave të mbajtura. Me kaq në të dy seksionet, sipas programit, mori fund mbajtja e kumtesave dhe e diskutimeve lidhur me çështjet që shtroheshin në to.

Seanca e tretë plenare filloi pas dite në orën 16.

Këtë seancë e drejtoi kryetari i Lidhjes së shkrimtarëve dhe artistëve të Shqipërisë prof. Dhimitër Shuteriqi. Të parit ai ia dha fjalën doc. *Anastas Dodit*, i cili mbajti parashtrësën e paraqitur nga komisioni i seksionit të parë, që u muar me trajtimin e problemeve të drejtshkrimit të zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve.

*Parashtrësë e komisionit të seksionit A  
rreth punimeve të këtij seksioni*

Gjatë tri ditëve pjesëmarrësit e seksionit A ndoqën me vëmendje e interesim kumtesat e diskutimet që u zhvilluan këtu rreth problemeve të vokalizmit e të konsonantizmit.

Në këtë seksion u mbajtën 57 kumtesa e diskutime nga gjuhëtarë, shkrimtarë, mësues e punonjës të tjerë lidhur me çështjen e shqipes letrare dhe të drejtshkrimit të saj.

Problematika e shumanshme dhe argumentimi shkencor i mendimeve tregojnë dhe një herë se për çështjet e gjuhës letrare shqipe dhe të drejtshkrimit të saj interesohen gjallërisht, mendojnë dhe preokupojnë një masë e gjerë mësuesish, shkrimtarësh, punonjësish të shtypit dhe të kulturës etj.

Kumtesat dhe diskutimet e zhvilluara i sollën Kongresit një mendim më të shëndoshë e objektiv, i sollën kërkesat e praktikës gjuhësore, të shkollës e të shtypit, e këto padyshim do t'i bëjnë rregullat e ardhshme të drejtshkrimit më të përsosura e më të qëndrueshme.

Duke miratuar tezat kryesore që u shtruan në referatin «Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj» si dhe parimet e zgjidhjet kryesore të projektit të «Rregullave të drejtshkrimit të shqipes» të vitit 1967 punimet e këtij seksioni sollën në të njëjtën kohë vërejtje e propozime të rëndësishme për shumë çështje të veçanta, që përbëjnë një kontribut të çmuar për përpunimin e mëtejshëm dhe hartimin përfundimtar të «Rregullave të drejtshkrimit të shqipes».

Në kumtesat dhe diskutimet paraqiten vërejtje dhe sugjerime për parimet e përgjithshme të ndërtimit të rregullave të drejtshkrimit si edhe vërejtje e propozime për rregulla që kanë të bëjnë me zgjidhje të çështjeve të veçanta.

Nga sugjerimet për çështje të përgjithshme po përmendim:

Rregullat të jenë të thjeshta e të njësuar, të kenë karakter përgjithësues, që të shërbejnë si çelës për të zgjidhur edhe raste të tjera të të njëjtit tip;

Zgjidhjet të kenë karakter sa më sistemor dhe konsekuent;

Rregullat e drejtshkrimit edhe për anën tingullore të gjuhës të mbështeten në trajta sa më të përbashkëta të shqipes letrare kombëtare;

Rregullat e drejtshkrimit të mos trajtojnë çështje, që për gjendjen e sotme të zhvillimit të gjuhës letrare, për praktikën e sotme gjuhësore, janë të zgjidhura e të kapërcyera, si p.sh. drejtshkrimi i ë-së së theksuar, që i përgjigjet një a-je hundore të gegërishtes (*zë-zëri, gjë-gjëja, nënë-nëna* etj.); togjet e zanoreve *ua, ye* në raste si *duar, grua, dyer, u thye*; ndërrimet *ye-y, je-i* në fjalë si *lyej-lyhet, mbjell-mbillni*; drejtshkrimi i grupeve *mb, nd, ng, ngj* etj.

Nga kumtesat dhe diskutimet në këtë seksion doli se të gjithë janë të mendimit që parimi kryesor i drejtshkrimit të shqipes duhet të jetë parimi fonetik. Kjo argumentohet me mundësitë që na jep sistemi grafik i shqipes, me traditën tonë drejtshkrimore dhe me synimin për të vendosur një lidhje të ngushtë midis formës së shkruar dhe formës së folur të gjuhës letrare.

Parimi fonetik duhet të zbatohet në të gjitha rastet kur shqiptimi letrar paraqitet i njësuar. Por, përveç parimit fonetik, do të zbatohen edhe parimi morfologjik e parime të tjera për të ruajtur në shkrim njësinë e trajtave gjuhësore dhe për të ngritur në normë trajta sa më të përbashkëta për gjithë kombin.

Nga vërejtjet dhe sugjerimet për rregulla dhe zgjidhje të çështjeve të veçanta po përmendim:

Për fjalët me *e* të theksuar që ndiqen ose kanë qenë ndjekur nga një bashkëtingëllore hundore u miratua zgjidhja që jep projekti për të ngritur në normë variantin me *e*. Pati mendime që edhe fjalët *vë, zë, lë*, mund të shkruhen me *e*;

Për zanoren *ë* të patheksuar në vija të përgjithshme u miratua qëndrimi i mbajtur në projekt, por u bënë dhe një varg vërejtjesh të rëndësishme. Pothuajse të gjithë ata që morën fjalën ishin të mendimit që, për *ë*-në në trup të fjalës, kur ajo nuk shërben si treguese e kategorive morfologjiko-semantike, të shkohet më tej në zbatimin e parimit fonetik, në mënyrë që shkrimi t'i afrohet më shumë gjendjes së sotme të shqiptimit letrar. Por duhet të synohet që heqja e *ë*-së të mos errësojë strukturën e sotme trajtëformuese dhe fjalëformuese të fjalës.

U bënë këto vërejtje të veçanta për drejtshkrimin e *ë*-së së patheksuar:

a) Të mos shkruhet *ë*-ja e patheksuar në fjalë të tilla si *arësye, arësim, arësimtar, këqyr, dëlir, bërryl* etj., drejtshkrimi i të cilave mbështetet në parimin historik-etimologjik;

b) Të mos shkruhet *ë*-ja fundore tek emrat e gjinisë mashkullore të tipit *lumë, lëmë, ballë, djalë, burrë, kalë, gjumë*.

Në pajtim me këtë u propozua që të shikohet edhe kategoria e emrave në origjinë asnjanes, që dalin më *-ë*, p.sh. *gjalpë, dyllë, djathë*, etj.;

c) Për fjalët me temë në *-ër, -ël* u shpreh mendimi që drejtshkrimi i tyre të shihet në sistem. Gjatë fleksionit *ë*-ja të mos pasqyrohet në shkrim. Ashtu si *letër-letra, vepër-vepra, lodër-lodra, libër-libri* të bëjnë dhe *dhelprë-dhelpra — dhelprës, gjarpër-gjarpri-gjarpri, i verbër - i verbri - të verbrin*, meqë grupet e formuara nuk konsiderohen të vështira për t'u shqiptuar.

Po kështu në fjalët e prejardhura, të formuara prej temash më *-ër* me anë prapashtesash që fillojnë me zanore, kur përpara *ë*-së ndodhet një bashkëtingëllore e zëshme, u shpreh mendimi që *ë*-ja të mos shkruhet, meqë karakteri i bashkëtingëllores, e zëshme ose e shurdhët, nuk luan ndonjë rol në ruajtjen e *ë*-së. Ashtu si *letër-letra-letrat, vepër-vepra-veprorë, i vjetër - i vjetri-vjetroj, regjistër-regjistri-regjistroj* të bëjnë dhe fjalët e tipi *libër-libri-librari, lodër-lodra-lodroj, i poshtër - i poshtri-poshtroj, emër-emri-emroj* etj. Në ato raste kur *ë*-ja bie gjatë fleksionit, të bjerë edhe gjatë derivacionit;

ç) Për foljet *flas, hyj, bie, shpie, shtie, zë, përzë* në mënyrën

urdhërore u shpreh mendimi që të dalin pa -ë (*fol, hyr, shtjer* etj.);

d) Drejtshkrimi i ë-së fundore dy rrokje larg theksit të zgjidhet në mënyrë më konsekuente si në sistemin emëror, ashtu dhe në sistemin foljor;

e) U shpreh mendimi që tek mbiemrat e tipit *i athët, i cekët, ë-ja* në rrokje të hapur të bjerë: *i cekti, i athti* etj.;

f) Në pajtim me sistemin, fjalë të tilla si *ditë, natë, gram, milion, dynym* etj. në shumës të dalin me -ë; *ditë, natë; gramë, milionë, dynymë* etj.

Për zanoren *u*, në fjalët që mbarojnë me -ull, -ur, u miratua qëndrimi që është mbajtur në projekt, që kjo zanore të shkruhet si e tillë në fjalët e tipit *kukull-kukulla, lepur-lepurush, kumbull-kumbulla* etj.;

Për togjet e zanoreve *ue, ye* në formime të tipit *mësues, (plani) rregullues, i rrëmbyeshëm* (norma drejtshqiptimore e të cilave ende s'është kristalizuar përfundimisht) mendimi i përgjithshëm është që ato të shkruhen të plota (*ue, ye*), për të ruajtur qartësinë e morfemës fjalëformuese. Por pati dhe një propozim që këto grupe të shkruhen *u, y* në të gjitha rastet e mësipërme.

Për apostrofin u miratua qëndrimi që mbahet në projektin e Rregullave të drejtshkrimit, por propozohet që këtu të shtohet dhe kategoria e emrave të fafesisit të tipit *s'ëmës, t'anë* etj.

Mendimi i përgjithshëm është që apostrofi të mos përdoret në fjalët proklitike *në, më, të, së, që*, p.sh. *në ujë, në ardhtë, më iku, të erdhi, së ardhmes, që atëhere*.

Pati një propozim që *në*, si lidhës kushtore, të shkruhet me apostrof para fjalësh që fillojnë me zanore: *n'i dashtë, n'ardhtë* etj.

Për bashkëtingëlloret e zëshme në fund e në trup të fjalës para një bashkëtingëlloreje të shurdhët u kërkua zbatimi i parimit morfologjik, d.m.th. ato të ruhen si të tilla në shkrim. Kështu të trajtohet edhe fjala *këndez-i*, që në projekt jepet me -s; -*këndes*.

Për *sh-/ç-/zh-* nistore në përgjithësi u përkrah zgjidhja e dhënë në projekt, d.m.th. që përdorimi i këtyre parashtesave të kushtëzohet nga tingulli që vjen pas tyre, por u kërkua edhe që të shikohet mundësia për të mbajtur si parashtesa vetëm *sh-në* e *ç-në*, duke e përjashtuar ose duke e ngushtuar *zh-në* vetëm në disa fjalë të veçanta;

Për shkrimin e *s-/z-/c-* nistore u kërkua që të dallohen rastet kur ato shërbejnë si parashtesa nga rastet kur janë thjesht tinguj nistorë. Në këtë mënyrë të lejohet shkrimi me *c* i fjalëve si *cfilit, cfurk*, pa varësisht se tingulli pasues është bashkëtingëllore e shurdhët, por si parashtesë, para të shurdhëtave, të përdoret vetëm *s-*: *skuq*, kurse para të zëshmeve *z*: *zbardh, zmadhoj*.

Të ngrihet në normë vetëm trajta *godiste*, duke përjashtuar trajtën *goditte*;

Për shkrimin e *j-së* te emrat femërore me -i të theksuar përgjithësisht u pranua zgjidhja e projektit, por pati edhe kërkesa për shkrimin e *j-së*: *shtëpija, liriya* etj.

Për formimin e trajtës së shquar të emrave me *o-* të pathek-suar u kërkua që si trajtë normative të jetë ajo me -*oja*: *Koçoja, pakoja*, por pati dhe mendime që të lejohet edhe trajta e dytë *Koçua, pakua*.

Për shkrimin e trajtave proklitike *ia, iu* u shprehën mendime të ndryshme: më tepër mbizotëron mendimi që të ruhet struktura morfologjike e tyre, d.m.th. të shkruhen *ia, iu* pavarësisht nga shqiptimi *ja, ju*. Kjo gjen analogji në sistemin morfologjik me trajtat si *vëllai, babai, ai shkoi, punoi* që shkruhen me *i*, por lexohen me *j*. Por disa për këtë çështje u bashkuan me zgjidhjen e projektit që trajtat e shkurtra edhe në pozicionin proklitik të shkruhen me *j*;

Në lidhje me shumësin me *-nj* ose me *-j* të emrave ose të mbiemrave, u vu në dukje se në gjuhën letrare të shkruar e të folur trajta me *nj* është mbizotëruesja, por duke marrë parasysh shtrirjen e gjërë dialektore të mbaresës *j*, u propozua që edhe kjo rregull të rishikohet, duke qenë se vihet re dhe një prirje e gjallë për mbaresën *-j*.

Për bashkëtingëlloret *l, ll* në fjalët shqipe u pranuan zgjidhjet e projektit, duke shtuar që të shkruhen me *ll* e jo me *l* fjalët: *balluke* dhe *pllakos*, ndërsa me *l*: *pëlcas* dhe folja *dal* në të kryerën e thjeshtë. Për bashkëtingëlloret *r, rr* u kërkua që të trajtohen në mënyrë më të plotë rastet e alternimit *rr:r* në trajtat e ndryshme të së njëjtës fjalë si *marr-mora, nxjerr-nxora* etj.;

Për takimet e shkronjave, që mund të lexohen si një fonemë, u shprehën mendime të ndryshme; në përgjithësi u kërkua që të shmanget mundësia e leximeve të gabuara dhe në pajtim me praktikën dhe me traditën tonë drejtshkrimore, u propozua që në takimet *g-j, n-j, j-ja* të përfaqësohet me shkronjën *i*, ndërsa takimet *d, t, s, z* me *h*-në të ndahen me anë të një apostrofi ose të një vize. Por pati edhe përkrahës të zgjidhjes që jepet në projektin e 1967-ës d.m.th. që të lejohet takimi i këtyre shkronjave duke pasur parasysh se konteksti siguron një lexim të drejtë.

Për shkrimin e fjalëve dhe të emrave me prejardhje të huaj:

a) Për fjalët me burim nga gjuhët klasike u shpreh mendimi që drejtshkrimi i shqipes të bazohet në trajtat e këtyre gjuhëve dhe jo në trajta që paraqesin veçori fonetike të kësaj ose asaj gjuhe, nëpërmjet së cilës ka ardhur fjala në gjuhën shqipe;

b) Për ato tipe fjalësh, shqiptimi letrar i të cilave është njësuar dhe përgjithësuar me kohë, ky kriter të jetë vendimtar në caktimin e trajtës së tyre drejtshkrimore; kështu të shkruhet *aksion, funksion, biçikletë, çimento, kontroll, injorant, agnosticizëm* etj.;

c) Për fjalët e huaja që kanë *ia, iu, ie, io* me *i* të patheksuar në gjuhët përkatëse, pati disa kërkesa që ato në gjuhën shqipe të shkruhen me *j*, ashtu siç shqiptohen në shumicën e rasteve p.sh. *italjan, portjer* në pajtim edhe me fjalë shqipe si *shaljan, matjan* etj. Por përgjithësisht mbizotëroi kërkesa që të ruhet mënyra e shkrimit të tyre ashtu siç e rekomandon projekti dhe siç e ka zbatuar gjerësisht praktika gjatë 20 vjetëve të fundit;

ç) Për bashkëtingëlloren *h* në fjalët e huaja u kërkua që shkrimi i saj të zgjidhet në bazë kriteresh më të njësuar, sidomos në pozicion nistore, p.sh. *Helenë* apo *Elenë, helikë* apo *elikë, Hindi* apo *Indi* etj.;

d) Për fjalët e huaja që shkruhen me *rr* në gjuhët përkatëse u kërkua që në gjuhën shqipe shkrimi i tyre të mbështetet në parimin

fonetik, d.m.t.h. të shkruhen me *rr* vetëm ato fjalë që shqiptohen në këtë mënyrë: *arrogancë, arrestoj, por koridor, korelacion* etj.

e) Emrat e përveçëm të huaj të shkruhen duke u mbështetur në traditën e përdorimit të tyre në gjuhën shqipe, duke marrë parasysh sa më shumë që të jetë e mundur edhe shqiptimin në gjuhën përkatëse;

f) Pati mendime gjithashtu që në botimet shkencore mund të ruhet shkrimi sipas grafisë së gjuhëve origjinale, krahas shkrimit që përfaqëson shqiptimin».

Pastaj në emër të komisionit të seksionit të dytë, që trajtoi çështje gramatikore, shkrimin e fjalëve bashkë ose ndaras, përdorimin e shkronjave të mëdha etj., lexoi parashtresën prof. *Mahir Domi*.

#### *Parashtresë e komisionit të seksionit B rreth punimeve të këtij seksioni*

Punimet e seksionit B u zhvilluan në një nivel të ngritur e në një atmosferë pune intensive e përgjegjësie të lartë shkencore. Referimet e mbajtura në këtë seksion miratuan në vija të përgjithshme parimet kryesore të projektit të «Rregullave të drejtshkrimit të shqipes» dhe pjesën dërmuese të zgjidhjeve që përmban ky projekt; njëkohësisht gjetën miratim edhe tezat themelore të referatit kryesor që u mbajt në këtë Kongres.

Mendimi i kumtuesve ishte se projekti i «Rregullave të drejtshkrimit të shqipes», botuar më 1967, shënon një ngjarje me rëndësi të madhe në historinë e gjuhës sonë letrare kombëtare. Ky projekt jo vetëm që dha zgjidhje në pajtim me realitetin objektiv dhe me prirjet më të përgjithshme të zhvillimit të gjuhës sonë letrare kombëtare, por që edhe një kontribut i drejtpërdrejtë në kristalizimin e normës letrare.

Në këtë seksion u mbajtën 46 kumtesa dhe diskutime. Vendin kryesor këtu e zunë çështjet morfologjike, përdorimi i shkronjave të mëdha, shkrimi i fjalëve bashkë, ndaras a me vizë në mes dhe trajtimi i rolit të shkrimtarëve e i kritikës letrare në njësimin e gjuhës letrare. Krahas vlerësimit të lartë që iu bë projektit të «Rregullave të drejtshkrimit të shqipes» dhe tezave qendrore të referatit dhe miratimit të përgjithshëm të tij, kumtesat dhe diskutimet e mbajtura gjatë seancave të ndryshme të këtij seksioni, ngritën një sërë problemesh që kërkojnë rivështrim të projektit, duke u zhvilluar rreth tyre një shkëmbim i lirë mendimesh. Nga këto kumtesa e diskutime dolën edhe një varg propozimesh e sugjerimesh për përmirësimin e plotësimin e mëtejshëm të rregullave.

Propozimet kryesore me karakter të përgjithshëm teorik-shkencor janë këto:

1. Të përcaktohet më shumë e më mirë fusha e veprimit të parimit fonetik, parimit themelor të drejtshkrimit të shqipes, dhe raporti i tij me parimin morfologjik, duke zgjeruar në disa raste fushën e veprimit të këtij të fundit.
2. Të ruhet, me sa është e mundshme, struktura morfologjike dhe

fjalëformuese e fjalës, duke zbatuar parimin morfologjik kur parimi fonetik e errëson këtë strukturë.

3. Çështjet drejtshkrimore të shikohen brenda sistemit, në mënyrë që të mënjanohen zgjidhje të ndryshme për probleme të ngjashme.

4. Të shkohet më tej në mënjanimin e normave dyvariantësh dhe të përjashtimeve të ndryshme, duke u mbështetur në radhë të parë në prirjen e përgjithshme të zhvillimit të shqipes letrare kombëtare.

5. Të bëhen përpjekje për një thjeshtim të mëtejshëm të rregullave të drejtshkrimit si sasi, duke bërë grupime më të gjëra e më përgjithësuese të fakteve gjuhësore dhe duke i paraqitur këto me formulime më të qarta. Të hiqen rregullat për fakte që nuk përbëjnë më probleme drejtshkrimore.

6. Në ilustrimin e rregullave të kihet kujdes që të mos përdoren trajta e fjalë dialektore.

Si propozime konkrete për përmirësimin e plotësimin e Rregullave të drejtshkrimit në seksionin B u bënë këto:

1. Të përfshihet në Rregullat e drejtshkrimit pjesa kushtuar çështjeve gramatikore, por duke bërë një zgjedhje e përcaktim më të mirë të fakteve që do të përfshihen aty.

2. Të kihet parasysh më shumë mënjanimi i homografëve, kur është e mundshme. Kështu del nevoja e rishikimit të ortogrameve *ja*, *ju* për bashkimet e trajtave të shkurtëra të përemrave vetorë, duke pranuar ortogramet *ia*, *iu*, për t'i dalluar nga pjesëza *ja* dhe nga përemri vetor *ju*.

3. Duke u mbështetur në parimin morfologjik dhe në nevojën e rrafshimeve, që të mënjanohen përjashtimet, të mos shkruhen me *ë* në fund, në vetën e dytë njëjës të urdhërores, disa folje me temë në bashkëtingëllore si: *fol*, *bjer* etj. Po në këtë vështrim të shikohet *ë*-ja fundore në emëroren njëjës të një numër i kufizuar emrash mashkullorë si *lum*, *kal* etj.

4. Të vështrohet për mënjanimin e trajtave dyfishe në rasat gjindore-dhanore-rrjedhore shumë të shquar; *maleve* e *malevet*.

5. Të njësohet, duke u caktuar si normë e vetme shkrimi, *jua* i bashkimit të trajtave të shkurtëra *ju* dhe *e* të përemrave vetorë (*jua* dhashë).

6. Të vështrohet më mirë drejtshkrimi i rasteve të ndryshme të përdorimit të nyjës së përparme, duke u marrë më shumë në konsideratë gjendja e sotme e gjuhës sonë dhe prirjet e saj.

7. Të vështrohet më tej çështja e shumësit me *-nj* të emrave si *ullinj*, *ftonj*, *barinj*, për të cilat pati edhe kërkesa që të shkruhen me *-j*.

8. Të shikohet mundësia e mënjanimit të zgjidhjes dyfish *-s/-t* të foljet e tipit *shëtis*, duke pasur parasysh prirjen e sotme të gjuhës letrare; të shkruhet me *-st* veta e tretë njëjës e së pakryerës së këtyre foljeve dhe e foljeve të tjera analoge.

9. Të pasurohet udhëzuesi drejtshkrimor me rregulla për shkrimin e pjesëzave e të pasthirmave.

10. Çështjet e lidhura me shkrimin e fjalëve bashkë, me vizë në mes ose ndaras të zgjidhen në bazë të konceptit të drejtë shkencor për fjalën, fjalën e përbërë, emërtimin e pathjeshtë dhe togfjalëshin, duke

pasur parasysh veçoritë e fjalës në gjuhën shqipe si njësi tërësore me strukturë të mbyllur fonetike, gramatikore dhe semantike.

11. Të vështrohet për zgjidhje më konsekuente të shkrimit ndaras a bashkë të numërorëve themelorë në rastet e ndryshme e për ndonjë çështje tjetër drejtshkrimore të tyre.

12. Në bazë të prirjes së shqipes letrare drejt njëfjalësimit të mjaft togfjalëshave, të rivështrohet shkrimi ndaras i disa ndajfoljeve, para-fjalëve dhe lidhëzave. Në këtë drejtim të ketë zgjidhje më të njësishtme për rastet e ngjashme, duke u mënjanuar shkrimi inkonsekuent i disave prej tyre si *meqënëse, megjithëse, dhe në qoftë se, sado që, edhe pse* etj.

13. Të vështrohet çështja e mbajtjes në drejtshkrimin tonë e vizës lidhëse në fjalët e huaja.

14. Të vështrohet kapitulli i shkronjave të mëdha për të marrë një paraqitje më sistematike, më konsekuente e për t'u plotësuar me raste të tjera.

15. Të ndiqen kritere të njëjta në shkrimin e emërtimeve të përbëra të institucioneve, të festave e të toponimeve, duke parapëlqyer shkrimin me shkronjë të madhe të të gjitha pjesëve përbërëse të tyre. Të mos bëhet dallim midis institucioneve e organizatave qëndrore dhe të tjera.

16. Të vështrohet mundësia që të marrë një përcaktim sa më praktik drejtshkrimi i emrave gjeografikë të tipit *Kanali i Korfuzit*.

17. Të përcaktohet më saktë e në mënyrë më të plotë përdorimi i shkronjave të mëdha për qëllime stilistike.

18. Të zbatohen kritere të njësuara në shkrimin e shkurttimeve. Të plotësohet kjo pjesë edhe në raste të tjera që nuk janë pasur parasysh.

19. U shpreh mendimi që për shkurtimet e tipit *UNESCO, NATO*, etj. të ngrihet në normë shkrimi me shkronja të mëdha.

Në seksion u ngritën edhe një sërë çështjesh të tjera më të veçanta dhe u bënë edhe propozime të tjera, që nuk janë përfshirë në këtë parashtrësë. Ato sigurisht do të studjohen e do të kihen parasysh në hartimin përfundimtar të Rregullave të drejtshkrimit të shqipes.

Seksioni shprehu bindjen se, duke pasur parasysh këto vërejtje e sugjerime në përpunimin përfundimtar të drejtshkrimit të gjuhës sonë, ky do të përmirësohet e do të plotësohet për t'ju përgjigjur edhe më mirë detyrave të tij, duke i dhënë gjuhës letrare mjetin e nevojshëm që i duhet asaj për t'u ngritur në një shkallë më të lartë përpunimi e normativizimi.».

Rreth dy parashtrësave të pranishmit në Kongres bënë diskutime, duke shfaqur mendimet e tyre. Në përgjithësi diskutuesit miratuan parashtrësat e të dy komisioneve, që pasqyronin rezultatet kryesore të arritura në punimet e dy seksioneve, si dhe bënë disa vërejtje e plotësime të mëtejshme.

Me kaq u mbyll seanca e tretë plenare e Kongresit të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

Më datën 24 nëntor pas dite Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe i vazhdoi punimet në seancën e katërt plenare. Kjo seancë u drejtua nga prof. Mahir Domi.

Në fillim prof. *Androkli Kostallari*, në emër të Komisionit të hartimit të projektrezolutës së Kongresit, bëri disa sqarime e plotësime

për projektrezolutën, të cilat pasqyronin kërkesat dhe mendimet e shfaqura në punimet e seancave plenare e të dy seksioneve të Kongresit.

Pastaj e morën fjalën mjaft delegatë, të cilët duke shprehur miratimin e tyre të plotë për projektrezolutën, bënë edhe disa vërejtje e propozime për ndryshime të veçanta.

«Në themel të kësaj projektrezolute, — tha prof. *Shaban Demiraj* në diskutimin e tij, — ashtu sikurse në themel të të gjitha kumtesave, diskutimeve dhe artikujve të shumtë të botuar gjer më sot për çështjen e drejtshkrimit të shqipes, qëndron kërkesa e ligjshme për kristalizimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të shqipes letrare kombëtare, e cila për gëzimin e të gjithë shqiptarëve është bërë tashmë një realitet objektiv». Prof. *Aleks Buda* në diskutimin e tij përshkroi rrugën e lavdishme që ka përshkuar zhvillimi historik e kulturor i popullit tonë; «Ne e dimë — tha ai, — se me sa vështirësi luftuan stërgjyshërit e etërit tanë, për të krijuar atë bazë mbi të cilën rrojmë e punojmë në një etapë më të lartë ne sot». Pastaj ai foli për punën e brezave të sotëm të dijetarëve për gjuhën dhe shprehu miratimin e tij të plotë për projektrezolutën paraqitur Kongresit. Edhe mësuesi i popullit *Kolë Koci* mbështeti në diskutimin e tij të gjitha çështjet e përfshira në projektrezolutë dhe në emër të brezit të vjetër të mësuesve shprehu gëzimin e madh për këtë fitore të rëndësishme të kulturës kombëtare. «Edhe unë, — tha ndër të tjera *Isa Bajçinca*, — pajtohem gjithashtu me të gjitha konstatimet që janë vënë në projektrezolutë». Më tej ai bën disa vërejtje të pjesshme. Diskutuan rreth projektrezolutës gjithashtu *Luigj Franja, doc. Munir Reso, doc. Dalan Shaplllo, Sefedin Sulejmani (Shkup), Drita Garuci, prof. Zihni Sako, Shefqet Hoxha, bashk. shk. vj. Lirak Dodbiba, Niko Tanini, Petro Janura (Shkup), Kristaq Shtëmbari, Mikel Zavalani, Remzi Pernaska, Fatmir Agalliu.*

Pas diskutimeve, projektrezoluta u hodh në votë dhe u miratua njëzëri nga delegatët.

Në këtë seancë u lexuan edhe telegrame e letra përshëndetjeje, që i erdhën Kongresit nga institucione të ndryshme, nga punonjës të arësimit e të kulturës, nga nxënës e studentë, studjues dhe dashamirës të gjuhës shqipe brenda dhe jasht vendit, si nga «Mësonjëtorja e parë shqipe» e Korçës, nga nxënësit dhe mësuesit e shkollës «Demir Gashi» në Peshkopi, nga nxënësit dhe mësuesit e shkollës që mban emrin e lëvruarit të gjuhës shqipe Konstandin Kristoforidhi në Elbasan, të shkollës «Asim Zeneli», në Gjirokastër, nga kolektivat mësues e nxënës të shkollës «Petro Nini Luarasi» në Tiranë dhe «29 Nëntori» në Shkodër, nga trupa profesioniste e teatrit «Migjeni» dhe studentët e Institutit pedagogjik në Shkodër, etj. Në to pasqyrohet jehona e gjerë që ngjalli Kongresi i drejtshkrimit të shqipes në opinionin shoqëror në të gjitha anët e vendit tonë. Në dhjetra e dhjetra telegrame e letra shprehet entuziazmi i masave të gjëra punonjëse, që i ndoqën punimet e Kongresit me interesim të madh, duke e vlerësuar atë si një ngjarje të shënuar për kulturën tonë kombëtare dhe si një sukses të shkencës së re shqiptare.

Në to gjen edhe kërkesat e dëshirat për trajtën përfundimtare të rregullave të drejtshkrimit të shqipes. Punonjësit e arësimit e të kulturës njëkohësisht premtojnë se do të punojnë me zell e këmbëngulje

për të vënë në jetë vendimet e Kongresit të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

Gjithashtu telegrame i erdhën Kongresit nga mësuesi i gjuhës shqipe nga Ulqini i Malit të Zi Bajram Rexha, nga Faik Shkodra dhe Musa Musllia të gjimnazit të Kamenicës së Kosovës; ndërsa prof. Mark Krasniqi nga Prishtina, në telegramin e tij ndër të tjera shkruan: «Kongresit të drejtshkrimit të gjuhës shqipe i uroj sukses në punën e tij të rëndësishme historike për kulturën kombëtare. Organizatorët dhe pjesëmarrësit e Kongresit i përshëndes përzemërsisht». Telegramë të tilla urimi i erdhën Kongresit edhe nga arbëreshët e Italisë — nga Xhuzeppe Skiro, profesor i Universitetit të Romës, nga Antonio Belushi nga San Konstantino Albaneze etj., si dhe nga albanologë nga vende të tjera — nga studjuesi i Universitetit të Insbrukut (Austri) Herman Olberg, nga prof. Harallamb Mihaesku i Institutit të studimeve për Evropën Juglindore në Bukuresht (Rumani) etj.

Pastaj përshëndetën Kongresin studjues të gjuhës shqipe nga Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi.

I pari e mori fjalën dekani i Fakultetit filozofik të Universitetit të Prishtinës, prof. *Idriz Ajeti*. «Përpjekjet e shqiptarëve, — tha ai ndër të tjera, — për të krijuar, stabilizuar dhe njësuar gjuhën e tyre letrare, që në plan të parë përfshinin edhe zgjidhjen e problemit të alfabetit, të drejtshkrimit, janë të lidhura ngushtë me punën dhe lëvizjet e mëdha politiko-shoqërore e kulturore, në pragramin e të cilave lufta për mbrojtjen, lëvrimin dhe ngritjen e gjuhës amtare zinte një vend të dorës së parë. Kongresi ynë i drejtshkrimit është, pa kurrëfarë dyshimi, kurorëzimi i të gjitha përpjekjeve të mundimshme shumëshekullore jo pa flijime e dëshmorë.

Mbi bazën e shndërrimeve të thella historike-ekonomike-shoqërore të pasqirimit, të kryera në shoqërinë socialiste të Shqipërisë së re, ndikimi i faktorit subjektiv të shoqërisë në procesin e zgjidhjes së gjuhës letrare, kujdesi i saj për përhapjen e kulturës në masat e gjera të popullit, organizimi i institucioneve kërkimore-shkencore, kanë gjetur shprehjen e tyre të plotë.

Funksioni i gjuhës së njësuar të përbashkët letrare ka gjetur shprehjen e saj në Jugosllavi — në Kosovë, në Maqedoni e në Mal të Zi, në të gjitha veprimtaritë shoqërore. Ky është një hap i rëndësishëm për zgjerimin e funksioneve të gjuhës shqipe dhe për pasurimin e saj.

Në emër të delegatëve dhe të pjesëmarrësve nga Jugosllavia, të ftuar të ndjekin punimet e Kongresit të drejtshkrimit të gjuhës shqipe, falënderojmë nga zemra organizuesit e Kongresit. Aprovojmë rezolutën e nxjerrë nga Kongresi, duke ju siguruar se drejtshkrimin e dalë nga ajo do ta vëmë në zbatim në të gjitha veprimtaritë shoqërore të shqiptarëve, që jetojnë në Jugosllavi — në Kosovë, në Maqedoni e në Mal të Zi».

Pastaj e përshëndeti Kongresin drejtori i Njësisë së bashkuar të punës botuese «Flaka e vëllazërimit», në Shkup, *Sefedin Sulejmani*.

«Më lejoni, — tha ai, — që në emër të delegatëve dhe të ftuarve nga RS e Maqedonisë, si dhe në emër të institucioneve që përfaqësojmë, të përshëndes përzemërsisht Kongresin e drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

Kongresi i sintetizoi të gjitha përpjekjet dhe arritjet në lëmin e

zhvillimit të gjuhës letrare shqipe dhe të drejtshkrimit të saj. Nga ana tjetër, ai hapi shumë horizonte, mundësi të reja dhe perspektiva të ndritshme për zhvillimin e gjuhës sonë.

U tha se detyrat e Kongresit janë historike. Të gjithë pajtohemi me këtë bindje, pse ato janë edhe aksiomatike.

Zotohemi, shoqe dhe shokë, që vendimet e Kongresit t'i bëjmë komponente dhe aksion patjetërsuar të jetës sonë të përditshme».

Kongresin e përshëndeti edhe drejtori i shkollës «Gjergj Kastrioti» në Ostros, Krajë (Mali i Zi), *Ismail Doda*. «Me përfundimin e këtij Kongresi — theksoi ai, — duke sendërsuar idealet, përpjekjet dhe frytet e punës së dijetarëve tanë nga shekulli XV, kur zuri të shkruhet gjuha shqipe, të një plejade të tërë shkencëtarësh dhe shkrimtarësh të mëpastajmë, të rilindasve dhe të gjithë atyre që ia kushtuan jetën gjuhës dhe popullit të vet, po shënojmë një datë të madhe të historisë dhe të kulturës sonë kombëtare.

Organizimi i shkëlqyer nga komisioni organizues, si dhe pjesëmarrja e studjuesve shqiptarë nga RP e Shqipërisë, nga krahina socialiste e Kosovës, RS e Maqedonisë dhe asaj të Malit të Zi, arbëreshëve të Italisë, albanologëve të huaj, ia shtuan edhe më tepër vlerën këtij Kongresi.

Duke shprehur një kënaqësi, kam nderin të nënshkruaj një akt të madh dhe të rëndësishëm historik për mbarë popullin shqiptar. Jam dakord me vendimet e marra dhe të gjithë ne, si edhe mbarë inteligjenca shqiptare, do të përpiqemi t'i zbatojmë dhe realizojmë me përpikmëri.»

Kongresin e përshëndeti pastaj studjuesi i njohur arbëresh *Josif Ferrari*, profesor i gjuhës shqipe në Universitetin e Barit. «Njësimi i gjuhës, — theksoi ai, — ka qenë kurdoherë në rendin e ditës dhe këtë e kanë ndjerë shumë të gjithë arbëreshët. De Rada i kushtoi këtij problemi vjetët e fundit të jetës së tij... Sot realizohet këtu në Tiranë ëndërra e këtyre shkrimtarëve tanë, të cilët, unë e ndjej veten se i përfaqësoj këtu dhe prandaj ju sjell përshëndetjen dhe miratimin e tyre shpirtëror. Në emrin e idealeve që ata përfaqësonin, unë ju them në përshëndetjen time se sot ndërgegja e çdo shqiptari e kërkon këtë njësim si një detyrë të shenjtë. Universiteti i Tiranës duhet të bëhet përherë e më tepër vatra jonë kulturore. Janë arsye historike që na detyrojnë t'ia besojmë kësaj vatre trashigiminë tonë kulturore. Unë i përshëndes dhe i falenderoj kolegët profesorë dhe të gjithë ata që e kanë organizuar këtë Kongres, që ka dalë në një mënyrë kaq të përsosur».

Pas prof. Josif Ferrarit e mori fjalën për të përshëndetur Kongresin albanologu francez *Hanri Buasen*, profesor në Institutin e gjuhëve orientale pranë Universitetit të Sorbonës. «Për mua, — tha ndër të tjera prof. H. Buasen, — është një kënaqësi e vërtetë si dhe një nder shumë i madh që t'i shpreh Kongresit të drejtshkrimit të gjuhës shqipe përshëndetjet e mia më të përzemërta si në emrin tim personal ashtu edhe në emër të kolegëve të mi, albanologë të Parisit... Unë jam habitur shumë gjatë zhvillimit të punimeve të Kongresit, kur pashë që një plejadë profesorësh dhe shkencëtarësh të shquar që drejtojnë studimet gjuhësore në Shqipëri, kanë ditur të ngjallin entuziazmin

ndër brezat e rinj, që ndjekin me këmbëngulje shembullin e më të vjetërve. Jam habitur shumë kur pashë numrin e madh të të rinjve, burra dhe gra, që kanë marrë pjesë në punimet e Kongresit me kumtesa e diskutime». Dr. *Bojka Sokolova*, e Institutit ballkanologjik të Akademisë bullgare të shkencave, në përshëndetjen e saj shprehu gjithashtu entuziazmin e saj për punimet e këtij Kongresi. «Referatet dhe kumtesat e shumta që u lexuan këtu dhe sidomos referati kryesor, — tha ajo, — ishin të një niveli të lartë shkencor dhe dhanë një kontribut të madh për sqarimin e shumë çështjeve të vështira e të ndërlikuara të drejtshkrimit. ... Ju siguroj se ne, albanologët bullgarë do të përpiqemi me të gjitha forcat t'u përmbahemi me përpikmëri normave të drejtshkrimit e të drejtshqiptimit të shqipes. Besoj se edhe ne, në punën tonë albanologjike, do të kemi ndihmën e përkrahjen tuaj të mëtejshme në kushtet e një bashkëpunimi reciprok shkencor». Në fund Dr. *Bojka Sokolova* i transmetoi Kongresit përshëndetjet e urimet e Institutit të ballkanistikës dhe të albanologëve të tjerë bullgarë.

Pastaj e përshëndeti kongresin dr. *Oda Buholc*, e Institutit të gjuhësisë në Berlin (RD Gjermane). «Rezultatet e Kongresit të drejtshkrimit, — tha ajo ndër të tjera, — do të na shërbejnë e do të na ndihmojnë në punën tonë. Megjithatë e kemi të qartë që kjo punë mund të kryhet në cilësinë e duhur vetëm po të kemi një bashkëpunim të mëtejshëm shkencor midis nesh... Kur të kthehemi në Republikën tonë, — theksoi ajo më tej — do t'u tregojmë edhe atyre shokëve që nuk merren me albanologji për rezultatet e rëndësishme që janë arritur në gjuhësinë shqiptare si dhe në lëmin e gjuhësisë së përgjithshme, rezultate që u pasqyruan në kumtesat e ndryshme, sidomos në referatin e shokut prof. *Androkli Kostallari*». Në fund dr. *Oda Buholc* i dorëzoi Institutit të gjuhësisë e të letërsisë një dhuratë simbolike botimesh shkencore gjuhësore.

Me kaq seanca e katërt plenare mori fund.

Më 25 nëntor para dite u mbajt seanca e fundit plenare e Kongresit të drejtshkrimit të gjuhës shqipe. Seanca u drejtua nga drejtori i Institutit të gjuhësisë e letërsisë dhe kryetari i Komisionit organizues të Kongresit prof. *Androkli Kostallari*. Në këtë seancë ndodheshin gjithashtu shokët *Enver Hoxha*, *Adil Çarçani*, *Hysni Kapo*, *Kadri Hazbiu*, *Manush Myftiu*, *Mehmet Shehu*, *Ramiz Alia*, *Pirro Dodbiba*, *Xhafer Spahiu*, kryetari i Kuvendit Popullor *Fadil Paçrami*, anëtarë të Komitetit Qendror të PPSH, të Presidiumit të Kuvendit Popullor, të Qeverisë e shokë të tjerë.

Sipas rendit të ditës, në seancën e pestë plenare u nënshkrua rezoluta e Kongresit, e cila u miratua njëzëri.

Në një atmosferë gëzimi dhe ndjenje të lartë përgjegjësie për këtë akt me rëndësi historike, të gjithë delegatët nënshkruan rezolutën, këtë dokument të rëndësishëm jo vetëm për ngulitjen përfundimtare të drejtshkrimit të njësuar të gjuhës shqipe, por edhe për gjuhën letrare shqipe në përgjithësi e për kulturën tonë kombëtare.

*Rezoluta u nënshkrua nga delegatët e Kongresit:*

- THOMA DELIANA — ministër i arësimit dhe i kulturës i RPSH.  
 Prof. ANDROKLI KOSTALLARI — drejtor i Institutit të gjuhësisë dhe të letërsisë të USHT, Tiranë.  
 Prof. MAHIR DOMI — gjuhëtar në Institutin e gjuhësisë dhe të letërsisë të USHT, Tiranë.  
 Prof. EQREM ÇABEJ — gjuhëtar në Institutin e gjuhësisë dhe të letërsisë të USHT, Tiranë.  
 Prof. IDRIZ AJETI — dekan i Fakultetit filozofik, Prishtinë.  
 Prof. DHIMITËR SHUTERIQI — kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, Tiranë.  
 Prof. ALEKS BUDA — historian në Institutin e historisë të USHT, Tiranë.  
 Dr. REXHEP QOSJA — drejtor i Institutit albanologjik, Prishtinë.  
 Prof. SHABAN DEMIRAJ — pedagog i gjuhës shqipe në Fakultetin e historisë dhe të filologjisë të USHT, Tiranë.  
 B. vj. shk. LIRAK DODBIBA — gjuhëtar në Institutin e gjuhësisë dhe të letërsisë të USHT, Tiranë.  
 KOLË KOCI — Mësues i Popullit, Tiranë.  
 Mr. REMZI NESIMI — pedagog i gjuhës shqipe në Akademinë pedagogjike, Shkup.  
 B. vj. shk. JORGJI GJINARI — gjuhëtar në Institutin e gjuhësisë dhe të letërsisë të USHT, Tiranë.  
 Doc. ANASTAS DODI — zv. dekan i Fakultetit të historisë dhe të filologjisë të USHT, Tiranë.  
 EMIL LAFE — gjuhëtar në Institutin e gjuhësisë dhe të letërsisë të USHT, Tiranë.  
 Doc. JUP KASTRATI — pedagog i gjuhës shqipe në Institutin e lartë pedagogjik, Shkodër.  
 Doc. ENGJËLL ANGONI — specialist për gjuhën shqipe në Ministrinë e Arësimit dhe të Kulturës, Tiranë.  
 ALI ABDIHOXHA — drejtor i Shtëpisë botuese «Naim Frashëri», Tiranë.  
 LUIGJ FRANJA — mësues i gjuhës dhe i letërsisë shqipe, Shkodër.  
 Prof. JOSIF FERRARI — studjues arbëresh, profesor i gjuhës shqipe në Universitetin e Barit.  
 Mr. AHMET KELMENDI — pedagog i gjuhës shqipe në Shkollën e lartë pedagogjike, Prishtinë.  
 AHMET LIMANI — mësues i gjuhës dhe i letërsisë shqipe, Mamurras.  
 AJET BYTYÇI — pedagog i gjuhës shqipe në shkollën e lartë pedagogjike, Prizren.  
 ALI DHRIMO — gjuhëtar në Institutin e gjuhësisë dhe të letërsisë të USHT, Tiranë.  
 BAHRI BECI — gjuhëtar në Institutin e gjuhësisë dhe të letërsisë të USHT, Tiranë.  
 BAJRAM HAJRULLAI — pedagog i gjuhës shqipe në filialen e USHT, Vlorë.  
 Prof. BEDRI DEDJA — zv. ministër i arësimit dhe i kulturës i RPSH.

- BESIM BOKSHI — pedagog i gjuhës shqipe në Shkollën e lartë pedagogjike, Gjakovë.
- Doc. DALAN SHAPLLO — pedagog i letërsisë shqiptare në Fakultetin e historisë dhe të filologjisë të USHT, Tiranë.
- DRITA GARUCI — mësuese e gjuhës dhe e letërsisë shqipe, Shkodër.
- DRITËRO AGOLLI — shkrimtar, Tiranë.
- DHIMITËR SAMARA — gjuhëtar në Institutin e gjuhësisë dhe të letërsisë të USHT, Tiranë.
- DHORI QIRIAZI — shkrimtar, Ersekë.
- ELSA VAKËFLLIU — mësuese e gjuhës dhe e letërsisë shqipe, Berat.
- FADIL PODGORICA — pedagog i gjuhës shqipe në Institutin e lartë pedagogjik, Shkodër.
- FATMIR AGALLIU — pedagog i gjuhës shqipe në Fakultetin e historisë dhe të filologjisë të USHT, Tiranë.
- FATMIR GJATA — shkrimtar, Tiranë.
- FERDINAND LEKA — gjuhëtar në Institutin e gjuhësisë dhe të letërsisë të USHT, Tiranë.
- GAQO PECI — mësues i gjuhës dhe i letërsisë shqipe, Korçë.
- ISMAIL DODA — drejtor i shkollës «Gjergj Kastrioti — Skënderbeu» Ostros (Krajë).
- HASAN SAZANI — mësues i gjuhës dhe i letërsisë shqipe, Gjirokastër.
- HENRIK LACAJ — pedagog në Fakultetin e historisë dhe të filologjisë të USHT, Tiranë.
- HYSEN QOSJA — pedagog i gjuhës shqipe në Institutin e lartë pedagogjik, Elbasan.
- ISAK BAJÇINCA — pedagog i gjuhës shqipe në Fakultetin filozofik, Prishtinë.
- ISMAIL BAJRA — drejtor i SGB «Rilindja», Prishtinë.
- ISMAIL KADARE — shkrimtar, Tiranë.
- JAKOV XOXA — shkrimtar, Tiranë.
- JANI THOMAJ — gjuhëtar në Institutin e gjuhësisë dhe të letërsisë të USHT, Tiranë.
- JORGO BULO — historian i letërsisë shqiptare në Institutin e gjuhësisë dhe të letërsisë të USHT, Tiranë.
- JORGJI ÇEREPI — pedagog i gjuhës shqipe në Filialen e USHT, Durrës.
- B. vj. shk. KOÇO BIHIKU — zv. drejtor i Institutit të gjuhësisë dhe të letërsisë të USHT, Tiranë.
- KOLË ASHTA — pedagog i gjuhës shqipe në Institutin e lartë pedagogjik, Shkodër.
- KRISTAQ SHTËMBARI — përgjegjës i kabinetit pedagogjik, Fier.
- LASGUSH PORADECI — shkrimtar, Tiranë.
- LUAN DINO — mësues i gjuhës dhe i letërsisë shqipe, Përmet.
- LUMNIE SHEHETILA — mësuese e gjuhës dhe e letërsisë shqipe, Elbasan.
- LLAZAR SILIQI — shkrimtar, Tiranë.
- MEHMET ÇELIKU — gjuhëtar në Institutin e gjuhësisë dhe të letërsisë të USHT, Tiranë.
- MENELLA TOTONI — gjuhëtar në Institutin e gjuhësisë dhe të letërsisë të USHT, Tiranë.

- MËRKUR ALIMERKO — drejtor i Shtëpisë botuese të librit shkollor, Tiranë.
- MIKEL ZAVALANI — mësues i gjuhës dhe i letërsisë shqipe, Korçë.
- MUFIT TREPÇA — mësues i gjuhës dhe i letërsisë shqipe, Peshkopi.
- Doc. MUNIR RESO — pedagog në Fakultetin e historisë dhe të filologjisë të USHT, Tiranë.
- NAIM BARDHI — mësues i gjuhës dhe i letërsisë shqipe, Kavajë.
- NESTI BELLOVODA — pedagog i gjuhës shqipe në Filialen e USHT, Korçë.
- NIKOLETA CIKULI — gjuhëtare në Institutin e gjuhësisë dhe të letërsisë të USHT, Tiranë.
- NIKO TANINI — redaktor letrar në gazetën «Zëri i Popullit», Tiranë.
- B. vj. shk. OSMAN MYDERRIZI — gjuhëtar, mësues veteran, Tiranë.
- B. vj. shk. PASHKO GECI — gjuhëtar, mësues veteran, Tiranë.
- Dr. PETRO JANURA — drejtor i Degës së gjuhës shqipe në Universitetin e Shkupit.
- PJETËR FUSHA — mësues i gjuhës dhe i letërsisë shqipe, Rubik.
- B. vj. shk. QEMAL HAXHIHASANI — folklorist në Institutin e folklorit të USHT, Tiranë.
- REMZI PËRNASKA — pedagog i gjuhës shqipe në Fakultetin e historisë dhe të filologjisë të USHT, Tiranë.
- SEFEDIN SULEJMANI — drejtor i Njësisë së bashkuar të punës botuese «Flaka e vëllazërimit», Shkup.
- SOFIKA ADHAMI — mësuese e gjuhës dhe e letërsisë shqipe, Vlorë.
- SOFIKA MORCKA — gjuhëtare në Institutin e gjuhësisë dhe të letërsisë të USHT, Tiranë.
- B. vj. shk. SPIRO FLOQI — gjuhëtar në Institutin e gjuhësisë dhe të letërsisë të USHT, Tiranë.
- Doc. STEFAN PRIFTI — gjuhëtar, Tiranë.
- STERJO SPASSE — shkrimtar, Tiranë.
- SHEFQET HOXHA — pedagog në Filialen e USHT, Kukës.
- SHEFQET MUSARAJ — shkrimtar, Tiranë.
- TOMOR OSMANI — pedagog i gjuhës shqipe në Institutin e lartë pedagogjik, Shkodër.
- XHEVAT LLOSHI — gjuhëtar në Institutin e gjuhësisë dhe të letërsisë të USHT, Tiranë.
- YLLI RULI — pedagog i gjuhës shqipe në filialen e USHT, Berat.
- ZANA DACI — pedagogë e gjuhës shqipe në Fakultetin e historisë dhe të filologjisë të USHT, Tiranë.
- Prof. ZIHNI SAKO — drejtor i Institutit të folklorit të USHT, Tiranë.
- ZHANETA NOVA — mësuese e gjuhës dhe e letërsisë shqipe, Gjirokastrë.

Pasi delegatët përfunduan nënshkrimin e rezolutës, në sallë shpërthyen duartrokitje të gjata e entuziaste.

Pastaj iu dha fjala veteranit të gjuhës shqipe *Halim Shpuza*, i cili përshëndeti Kongresin në emër të brezit të vjetër të arësimitarëve. «Përshëndes nga zemra pjesëmarrësit e këtij Kongresi, — tha ai ndër të tjerë, — për përfundimin me sukses të punimeve të tij, duke shprehur urimet e mia më të mira për lulëzimin e gjuhës dhe të letërsisë shqipe,

të kulturës e shkencës shqiptare, për zhvillimin e mëtejshëm të arësimit tonë kombëtar».

Në emër të brezit të ri përshëndeti pionierja *Lindita Sako*. «Ju morët vendime të rëndësishme, — tha ajo. Vendimet tuaja janë edhe për ne. E ne do t'i vëmë ato në jetë sa më mirë. Rregullat e drejtshkrimit do t'i përvetësojmë e do t'i zbatojmë të gjithë, që ta shkruajmë drejt e pa gabime gjuhën tonë të bukur».

Në fund drejtori i Institutit të gjuhësisë dhe letërsisë prof. *Androkli Kostallari*, mbajti fjalën e mbylljes.

*Fjala e mbylljes në Kongresin e drejtshkrimit të gjuhës shqipe, mbajtur nga prof. Androkli Kostallari*

«Kongresi ynë po i mbyll punimet e tij me një fitore historike për gjuhën dhe kulturën tonë kombëtare. Rezoluta që u nënshkrua nga delegatët e këtij Kongresi sanksionon jo vetëm njësimin e drejtshkrimit, por edhe njësimin e gjuhës sonë letrare kombëtare. Një shkallë e tillë zhvillimi e vë gjuhën shqipe në radhën e gjuhëve të përparuara, që pasqyrojnë të gjitha arritjet e qytetërimit të sotëm botëror.

Kjo fitore e rëndësishme në fushën e kulturës e të arësimit, që është kurorëzimi i përpjekjeve të shumë e shumë brezave, u arrit në epokën e lavdishme të ndërtimit të socializmit. Partia jonë e Punës dhe vetë shoku Enver Hoxha kanë treguar vazhdimisht një kujdes të pandërprerë për gjuhën tonë amtare, për këtë thesar të pazëvendësueshëm të popullit tonë. Ata na kanë porositur ta ruajmë atë si gjënë më të shtrenjtë, ta pastrojmë e ta pasurojmë, duke mbledhur me durim e këmbëngulje nga goja e njerëzve të thjeshtë, si pikat e vesës së kulluar, fjalën e shprehjen e gjallë të skalitur e të lëmuar nga mënjuria e nga shija mjeshtërore e popullit gjatë shumë qindvjeçarëve, ta zhvillojmë e ta përsosim atë dhe t'ua japim breznive të reja sa më të fuqishme e të gjithanshme.

Kongresi i drejtshkrimit ishte një hap përpara pikërisht në këtë rrugë. Ai kaloi në shtigje të vështira, shkencore, përfshiu në gjirin e tij pothuajse të gjitha problemet e drejtshkrimit të sotëm të shqipes dhe i zbrërtheu këto brenda caqeve të gjera të pikënisjes e të pikarritjes së gjuhës letrare kombëtare të njësuar. Të gjitha punimet e Kongresit u udhëhoqën nga një perspektivë e qartë — jo zgjidhje të veçanta, të shkëputura, anësore, por zgjidhje thelbësore, në rrugën e gjerë të njësimit e të përparimit të gjuhës letrare të përbashkët. Shikimi i problemeve në tërësinë e tyre në lidhjet e ndryshme midis tyre, duke u nisur nga kuptimi i drejtë i sistemit të gjuhës së sotme letrare shqipe dhe i mjeteve e i mënyrave të shprehjes e të paraqitjes së tij, e ndihmoi Kongresin të kapërcente shumë vështirësi. Vetë zgjidhjet e problemeve drejtshkimore u ndërthurrën prej tij në një sistem të vetëm. Kjo bëri që larmia krijuese e pikëpamjeve dhe e tezave që u shprehën gjatë punimeve të Kongresit të përshkohej nga një vijë themelore, nga një qëllim i përbashkët. Asnjëherë deri më sot në historinë e studimeve të shqipes nuk ka pasur një Kongres të tillë — me një gjerësi e me një thellësi kaq të madhe të mendimit shkencor shqip-

tar. Në Kongres u mbajtën më se 150 kumtesa, referime e diskutime, të cilat në përgjithësi u dalluan nga një përgjegjësi e madhe shkencore. Ato ishin fryt i një pune kërkimore, vëzhguese e përgjithësuese të gjerë dhe i një përvoje shumëvjeçare. Krahas disa problemeve — nje të sistemit fonetik të shqipes e të parimit fonetik, që u pranua nga të gjithë si parimi themelor i drejtshkrimit tonë, u rrahën edhe shumë çështje të sistemit morfologjik e të parimit morfologjik të drejtshkrimit. Shtrimi i problemeve, argumentimi shkencor dhe përfundimet e nxjerra nga kumtesat e diskutimet i kapërcyen shumë caqet e ngushta të drejtshkrimit dhe rrokën disa anë të rëndësishme të veçorive historike e strukturore të gjuhës sonë letrare, duke e çuar më tej ndriçimin teorik të tyre. Prandaj ky Kongres mund të quhet me plot të drejtë edhe si forumi më i gjerë shkencor që ka rrahur në tërësi problemin e normës letrare të njësuar të shqipes kombëtare, duke u dhënë përgjigje shumë pyetjeve që u shtruan në konferencat gjuhësore të vitit 1952. Mendimi i gjallë shkencor i tij nuk është diçka kalimtare, nuk merr fund me jehonën e disa ditëve. Ai zgjeron e pasuron trashëgimin teorik të shkencës gjuhësore shqiptare dhe ndihmon drejtpërsëdrejti për thellimin e trajtimit shkencor e sistemor të shumë çështjeve të strukturës fonetiko-gramatikore e leksikore të gjuhës së sotme shqipe.

Kongresi i drejtshkrimit tregoi edhe një herë pjekurinë e shkencës gjuhësore shqiptare, forcën e metodologjisë marksiste të kësaj shkence, rritjen e saj teorike, që përbën kurdoherë hapin më të vështirë për çdo shkencë. Ai tregoi se në zhvillimin e shkencës sasia dhe cilësia ecin kurdoherë bashkë, se nuk mund të ketë rritje të vërtetë cilësore, po një shkencë masive. Në Kongres u bashkuan përpjekjet e studjuesve të institucioneve kërkimore me ato të mësuesve të gjuhës e të letërsisë shqipe, që sollën nga shkolla një përvojë të gjatë, të shëndoshë e të pazëvendësueshme. Këto përpjekje të përbashkëta, që e kanë burimin tek bashkëpunimi krijues shumë i frytshëm i shkencës sonë gjuhësore me shkollën pas çlirimit, si edhe mendimi i mjeshtërve të fjalës artistike, i kritikëve letrarë e i njerëzve të kulturës në kuptimin më të gjërë, i lidhi zgjidhjet e Kongresit me nevojat e vërteta të jetës, u dha atyre karakter real, të kapshëm e konkret. Të gjitha këto, pa dyshim, do t'i bëjnë rregullat e drejtshkrimit më të qëndrueshme, më të thjeshta e praktike, më të gjalla e njëkohësisht, edhe më shkencore. Miratimi i njëzëshëm i Rezolutës së Kongresit, që ishte fryt i rrahjes së gjerë e të lirë të mendimit shkencor, i një analize të shumanshme e të imtë, i siguron drejtshkrimit tonë jo vetëm disa qindra zbatues të drejtpërdrejtë, por edhe një ushtëri të tërë përçuesish të vetëdijshëm të normës letrare tek masat e gjera — arësimtarë, shkrimtarë, punonjës të shtypit e të botimeve, njerëz të kulturës, të fjalës letrare të shkruar e të folur. Është puna e tyre që i bëri të mundshme vendimet e këtij Kongresi, do të jetë puna e tyre që do të çajë rrugën edhe për zbatimin e këtyre vendimeve. Vetë fjalët që u thanë për miratimin e Rezolutës tingëlluan si një zotim, i cili ngroh zemrat jo vetëm të atyre që marrin pjesë në këtë Kongres, por edhe të milionave që ndjekin me një ndjenjë të thellë gëzimi e mirënjohjeje punimet e tij.

Kongresi i drejtshkrimit qe edhe një ndihmë e madhe për zhvilli-

min e mëtejshëm të gjuhësisë shqiptare. Ai tregoi se ku duhet t'i përqëndrojmë më shumë përpjekjet tona në studimin e gjuhës së sotme shqipe dhe si mund të gërshetohen përpjekjet teorike e praktike për të ndihmuar masat e gjera punonjëse që ta përvetësojnë e ta zhvillojnë më tej gjuhën letrare të shkruar e të folur.

Sot del si një nevojë e ngutshme që një nga drejtimet kryesore të gjuhësisë shqiptare të jetë studimi i përdorimit të drejtë të kategorive e të njësive gjuhësore, studimi i normës letrare në shumanësinë e saj. Kjo fushë kërkimesh me të drejtë, në kohën tonë po ngrihet në një degë më vete të diturisë gjuhësore, në atë që quhet ortologji, sepse për çdo folës dhe shkruer gjuha ka rëndësi në radhë të parë jo si historik, po si një mjet i gjallë i shprehjes e i kumtimit të mendimit. Folësi e shkruesi ka nevojë të dijë si ta përdorë më mirë, drejt e pa gabime këtë mjet të fuqishëm e të pazëvendësueshëm që shoqëria njerëzore e ka krijuar për t'i shërbyer asaj si armë zhvillimi e përparimi. Pikërisht për këtë arsye sot përpara nesh çështjet e gjuhës letrare shtrohen, para së gjithash, si çështje të kulturës së gjuhës. Në këtë fushë është e domosdoshme që gjuhësia shqiptare të bëjë gjerësisht një hap të ri përpara — të kalojë nga lufta kundër gabimeve e parregullsive gjuhësore d.m.th. nga vështrimi i aspektit negativ, në luftën për një gjuhë të rregullt e sa më shprehëse, d.m.th. në vështrimin pozitiv. Trajtimi i çështjeve të kulturës së gjuhës është një fushë ku mendimet ndeshen shpesh herë, ku ballafaqohen objektiva me subjektiva, e përgjithshme me individualen. Këtu ka rëndësi të veçantë që të mos lejohen zgjidhje të rastit, sepse gabimet në këtë fushë marrin karakter masiv dhe është shumë vështirë të ndreqen. Pikërisht për këtë arsye në luftën për kulturën e gjuhës, për njohjen dhe përhapjen e ligjeve e të normave të përdorimit të gjuhës letrare shtrohet më me mprehtësi se kudo nevoja që të mbështetemi në ligjet gjuhësore, pavarësisht nga kundërshtimet e rastit. Historia kulturore e njerëzimit ka njohur kundërshtime të ashpëra edhe kundër maqinës me avull ose kundër trenit, automobilin e aeroplanit, kundër llampës me vajguri dhe llampës elektrike, por ligjet objektive të zhvillimit të shoqërisë e kanë bërë të vetën. Kështu ndodh edhe me ligjet gjuhësore. Kjo kërkon që punonjësit e gjuhësisë sonë normative të thellojnë përgatitjen e tyre teorike, që teoria mbi kulturën e gjuhës shqipe e të ligjërit shqip të zërë një vend shumë më të madh se deri më sot në studimet tona gjuhësore.

Studimet për kulturën e gjuhës si studime normative nuk mund të zhvillohen në mënyrë të veçantë e të shkëputur. Ato kanë nevojë që të mbështeten në studime më të thelluara në fushën fonetike e të fonologjisë, të gramatikës, të leksikut e të formimit të fjalëve. Ndër të tjera, përpara gjuhësisë shqiptare, nga kjo pikëpamje, marrin një rëndësi të veçantë edhe studimet në fushën e morfonologjisë, të cilat ende nuk kanë filluar.

Krahas kësaj, shtrihet lëmi i gjerë i stileve funksionale, ku studimi gjuhësor ndodhet në hapat e para. Mbi të gjitha, në këtë aspekt, del nevoja që të ndërmerren studime të shumanshme e sistematike për gjuhën e letërsisë artistike, d.m.th. për sferën më të lartë e më të ndër-

likuar të gjuhës sonë letrare, ku norma letrare dhe jonorma bashkë-jetojnë në një njësi stilistike dialektike.

Studimet në fushën e gjuhësisë normative kërkojnë që edhe dialektologjia shqiptare të shërbejë për to si një mbështetje më e drejtpërdrejtë. Studimet tona dialektologjike të derisotme, që kanë përfshirë shumicën e të folmeve e të nëndialekteve të shqipes, kanë dhënë një ndihmë më të drejtpërdrejtë për historinë e gjuhës shqipe, për rindërtimin e saj të brendshëm në drejtimin nga e sotmja në të kaluarën, ndërsa për problemet e gjuhës letrare ndihma e tyre ka qenë më tepër e tërthortë. Sot ne kemi nevojë të ngutshme dhe mundësi më të mëdha që t'i zgjerojmë e t'i plotësojmë drejtimet e këndet e vështrimit të dialektologjisë shqiptare. Studimet e deritanishme në këtë fushë pasqyrojnë, në radhë të parë, ligjërimin e *brezave pasivë* të fshatarëve që e kanë bërë brumosjen themelore gjuhësore aty nga fundi i shek. XIX e nga fillimi i shekullit tonë dhe nuk pasqyrojnë *ligjërimin e brezave aktivë të shoqërisë sonë, gjuhën e vërtetë, reale të fshatit e të qytetit të sotëm shqiptar, me të gjitha shtresëzimet e saj shoqërore*. Sot dialektologjia shqiptare ka mundësi të futet më gjerë në rrugën e *dialektologjisë sociale*, ta kthejë më shumë fytyrën nga e sotmja dhe e ardhmja, të studjojë proceset e gjalla që zhvillohen sot në shtresat e ndryshme shoqërore të mbartësve të dialekteve nga këndi i vështrimit të gjuhës letrare dhe në përputhje me këtë synim të sqarojë teorikisht disa nga problemet themelore të dialektologjisë sonë sociale e të përmirësojë më tej metodat kërkimore. Me një fjalë, pa hequr dorë nga detyrat e historisë së gjuhës, ajo duhet të merret më shumë me marrëdhënjet midis gjuhës letrare e dialekteve, të para si në gjendjen e sotme ashtu edhe në prirjet e zhvillimit. Në fund të fundit, pjesë e pandarë e historisë së gjuhës shqipe është edhe historia gjuhësore e ditëve tona, pra edhe zhvillimi i gjuhës së sotme letrare e i normës së saj kombëtare.

Dalja e gjuhësisë shqiptare në rrugën e trajtimit ballësor të problemeve të gjuhës letrare nuk varet nga vetë gjuhësia, por përcaktohet nga kërkesat objektive shoqërore të kohës sonë. Gjuhësia shqiptare ka qenë e lidhur vazhdimisht me problemet që ka shtruar vetë jeta dhe sot kjo lidhje është bërë më e fortë se kurrë. Është për t'u shënuar se në përgjithësi drejtimet e sferat e zhvillimit të albanistikës së sotme po tregojnë qartë se iku koha kur shqipja ishte objekt i ekzotikës së shkencës gjuhësore.

E pajisur me njohuri më të gjera e me përfundime shkencore më të thella gjuhësia shqiptare do ta përmirësojë më tej edhe ndihmën e saj për shkollën, kundrejt së cilës ajo ka detyrime të mëdha. Shoku Enver Hoxha ka theksuar se «linguistët tanë, shkencëtarë apo metodistë, duhet të luftojnë prirjen për t'u mësuar nxënësve gjuhën shqipe në mënyrë akademike, duke i mbushur e ngarkuar me gjithfarë kategorish, duke synuar për t'u dhënë edhe njohuri abstrakte e të thata, të tepërta dhe të panevojshme për jetën. Shkenca gjuhësore duhet të ndihmojë më shumë dhe më shpejt shkollën për një përvetësim me baza më të shëndosha dhe një aftësi më të madhe të përdorimit praktik të gjuhës së gjallë nga ana e nxënësve» (Enver Hoxha «Për re-

*volucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë», Tiranë, 1968, f. 27-28). Pa dyshim, mësimi i gjuhës, ashtu si çdo fushë e diturisë, ka edhe vësh-tirësitë e veta, kërkon përpjekje e durim. Por gjuha ka edhe bukuritë e saj të mëdha e të thella. Përpjekja jonë duhet të synojë që nxënësit t'i zbulojnë këto bukuri e ta duan gjithnjë më shumë gjuhën amtare e mësimin e saj. Dhe kjo arrihet vetëm atëhere kur e vështira nuk e mbulon të bukurën.*

Kongresi ynë i drejtshkrimit e ndihmon shkencën tonë gjuhësore t'i shohë më mirë e në mënyrë tërësore detyrat e saj në fushën e or-tologjisë, e në mënyrë të veçantë edhe në fushën e arësimit. Shkolla është, pa dyshim, hallka numër një nga duhet filluar për përvetësimin e normës letrare. Formimi gjuhësor që merret në shkollë ka rëndësi ven-dimtare. Ne, vërtet, mësojmë disa vjet, por shkruajmë e lexojmë tërë jetën. Dhe ajo që kemi mësuar në shkollë mbetet si një gur themeli në vetëdijen tonë gjuhësore.

Suksesi i Kongresit tonë u siguroa nga puna e palodhur e gjithë pjesëmarrësve të tij dhe e shumë e shumë punonjësve të kulturës e të arësimit që ushqejnë mendimin shkencor gjuhësor me kërkimet e tyre të vazhdueshme. Më lejoni t'u shpreh në emër të Komisionit organiza-tiv të gjithë pjesëmarrësve të Kongresit falënderimet më të thella për këto përpjekje që bënë të mundur zgjidhjen e një problemi kaq të rëndësishëm e të ndërlikuar siç është njësimi i drejtshkrimit të gjuhës sonë letrare. Një kontribut të veçantë sollën në këtë Kongres edhe studjuesit e lëvruesit e shqipes nga radhët e shqiptarëve që jetojnë në Jugosllavi — në Kosovë, në Maqedoni e në Mal të Zi; ky kontribut e çoi më tej veprën e tyre shumëvjeçare për përvetësimin, zbatimin e zhvillimin e gjuhës letrare kombëtare të njësuar. Kjo vepër i zgjeron dhe i shëndosh më tej edhe forcat e shkencës gjuhësore shqiptare, edhe forcat e lëvruesve të gjuhës letrare shqipe.

Punimet e Kongresit të drejtshkrimit dhe shkenca gjuhësore shqip-tare morën një vlerësim të lartë në përhëndetjet që u bënë dje nga një varg studjuesish albanologë të vendeve të tjera. Më lejoni t'i fa-lënderoj ata nga zemra për të gjitha fjalët që thanë dhe t'u premtoj çdo ndihmë nga ana e gjuhësisë sonë për zhvillimin sa më të madh të studimeve të sotme albanologjike.

Ne po ndahemi sot të frymëzuar nga bindje të thella shkencore e nga dëshira e zjarrtë për t'i vënë sa më parë në jetë vendimet e këtij Kongresi. Kodin e drejtshkrimit ne do ta plotësojmë edhe me «Fjalorin drejtshkrimor», me «Rregullat e drejtshqiptimit» dhe me «Rregullat për shenjat e pikësimit». Këto do të jenë mjete shkencore që do të ndih-mojnë të gjithë punonjësit ta shkruajnë e ta flasin qartë, në mënyrë të përpiktë e bukur gjuhën që na kanë lënë trashëgim të parët tanë. Përpjekjet tona shkencore, teorike e praktike do të bëhen kurdoherë më të gjalla, duke mos harruar asnjëherë se në jetën e gjuhës sonë norma dhe antinorma bashkëjetojnë e luftojnë me njëra-tjetrën.

Me forca të bashkuara — studjues e mësues të gjuhës shqipe, shkrimtarë, gazetarë, punonjës të fushës së gjerë të kulturës e të të gjitha fushave të tjera të punës mendore, së bashku me klasën tonë punëtore e me fshatarësinë tonë punonjëse le ta bëjmë luftën për

ërvetësimin e plotë e për lulëzimin e gjuhës sonë letrare një çë-  
tje të madhe të gjithë popullit tonë.

Në këtë Kongres, ashtu si gjithnjë, ne ndjemë kujdesin e përkrahjen  
ngrohtë e të fuqishme të Partisë sonë, të udhëheqjes së saj e të vetë  
hokut Enver Hoxha. Kjo i dha Kongresit tonë dhe i jep gjithë punës  
onë shkencore fuqi të reja për të ecur përpara. Ne i premtojmë Partisë  
onë se edhe në të ardhmen, në frymën e mësimëve të saj, do t'i  
ryejmë me nder detyrat që na shtrohen për zhvillimin e përpari-  
nin e shkencës, të gjuhës e të kulturës sonë socialiste.

Duke mbyllur Kongresin e drejtshkrimit të gjuhës shqipe, më le-  
oni t'ju uroj të gjithëve suksese të reja në këtë punë kaq të vështirë  
e të rëndësishme, e njëkohësisht kaq të bukur e fisnike».

Po këtë ditë Komisioni organizues i Kongresit të drejtshkrimit të  
gjuhës shqipe bëri mbledhjen e fundit.

Në këtë mbledhje kryetari i Komisionit organizues prof. Androkli  
Kostallari u dorëzoi nga një ekzemplar origjinal të rezolutës së Kongresit  
përfaqësuesit të studjuesve e lëvruesve të shqipes nga Kosova, dekanit  
të fakultetit filozofik të Universitetit të Prishtinës prof. Idriz Ajetit  
dhe përfaqësuesit të studjuesve e lëvruesve të shqipes nga Maqedonia,  
drejtuesit të katedrës së gjuhës e të letërsisë shqipe në Akademinë  
pedagogjike të Shkupit mr. Remzi Nesimit.

Me këtë rast ndodhej edhe Zëvendësministri i arësimit e i kulturës  
Bedri Dedja.

Prof. Idriz Ajeti dhe mr. Remzi Nesimi, pasi morën në dorëzim  
rezolutat, falënderuan për nderin që iu bënë dhe premtuan se do të  
punojnë me të gjitha forcat për zbatimin e plotë të rezolutës së Kon-  
gresit të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

Kështu *Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe* u dha fund pu-  
nimeve me sukses të plotë. Vendimet e tij e rezoluta e miratuar një-  
zëri dhe e nënshkruar nga delegatët janë kurorëzim i shkëlqyer i  
përpjekjeve të parreshtura për vite me radhë të studjuesve e lë-  
vruesve të gjuhës shqipe, të patriotëve e mendimtarëve shqiptarë,  
janë shprehje e frymës së lartë patriotike, të cilën populli ynë nuk e ka  
humbur asnjëherë në luftën e gjatë e të vështirë që i ka detyruar  
historia. Prandaj punimet e këtij Kongresi u ndoqën me vëmendje  
e interesim nga masat e gjera punonjëse, sepse gjuha amtare ka  
qenë kurdoherë një fill i pakëputur që ka lidhur breznitë edhe në  
çastet më të vështira të jetës së popullit tonë.

Duke marrë vendime të rëndësishme e me përgjegjësi, Kongresi  
i drejtshkrimit të gjuhës shqipe shtroi një varg detyrash për të ardh-  
men, për hartimin përfundimtar të rregullave të drejtshkrimit të shqi-  
pes. Referati, kumtesat e diskutimet e gjalla, që mbështeteshin në  
realitetin gjuhësor të sotëm dhe në prirjet e zhvillimit të mëtejshëm  
të shqipes letrare, u vunë vendimeve të Kongresit një bazë të shëndo-  
shë objektive. Karakteristikë e përgjithshme e punimeve të Kongresit  
ishte thellësia e analizës, përgjithësimi e argumentimi shkencor i çë-  
shtjeve dhe synimi drejt njësimi të plotë e përfundimtar. Kjo ishte  
rezultat i një pune shumëvjeçare kërkimesh e studimesh në të gjitha  
degët e gjuhësisë shqiptare, në fushën e fonetikës, të leksikologjisë, të  
gramatikës, të formimit të fjalëve, të stilistikës, të dialektologjisë etj.

Pa këto studime paraprake, të cilat kërkojnë padyshim një thellim të mëtejshëm në të gjitha drejtimet, nuk mund të zgjidheshin shumë çështje të drejtshkrimit të shqipes letrare. Studime të tilla, që janë botuar veçan ose në revista shkencore «Studime filologjike» e «Studia albanica», si dhe në vëllimet kushtuar Kongresit të drejtshkrimit të shqipes: «Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit», «Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe» (dy vëllime), «Dialektologjia shqiptare», «Probleme të gjuhës letrare shqipe dhe të drejtshkrimit të saj» (tri vëllime) etj., janë tani në dorë të kujt do që merret me fjalën e shkruar shqipe. Ato ndihmojnë për kuptimin e drejtë të normës së shqipes letrare dhe të drejtshkrimit të saj.

Një vlerësim të veçantë i bëri Kongresit të drejtshkrimit të gjuhës shqipe Partia jonë. Në fjalimin që mbajti në Vlorë me rastin e 60-vjetorit të shpalljes së pavarësisë dhe 28-vjetorit të çlirimit të Atdheut, shoku Enver Hoxha ndër të tjera tha:

«Para disa ditësh zhvilloi punimet historike Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës sonë të bukur. Kjo është një fitore e pallogaritshme në mes të aq fitoreve të tjera madhështore që ka korrur populli ynë me luftë, me përpjekje e me zotësi.

Ne përshëndesim nga zemra bijat dhe bijtë e mësuar e të talentuar të popullit tonë, që në atë kuvend historik dhe në rrugën e traditave të shkëlqyeshme të frashërllinjve dhe të rilindasve tanë të tjerë, i dhanë një shkëlqim akoma më të madh gjuhës, thesarit më të madh të një populli.

Ne përshëndesim nxehtësisht nga zemra veçanërisht dijetarët e shquar, vëllezërit tanë shqiptarë të Kosovës, Maqedonisë e Malit të Zi, që dhanë kontributin e tyre të çmueshëm në vendosjen e drejtshkrimit të gjuhës së përbashkët amtare. Ne u urojmë nxënësve, studentëve, gjuhëtarëve, profesorëve e mësuesve vëllezër shqiptarë të Kosovës, Maqedonisë e Malit të Zi suksese akoma më të mëdha në përpërimin e madh që kanë bërë në lëvrimin e gjuhës shqipe, gjë që e konsiderojmë si fitore të përbashkët».

Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe do të mbetet një nga ngjarjet më të shënuara në jetën e gjuhës letrare shqipe e të kulturës kombëtare të popullit shqiptar.